



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 26 SHKURT 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 17:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datave 07.02.2019 dhe 14.02.2019 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektakteve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar" *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektligji “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 26 SHKURT 2019

ndryshuar" (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Projektvendimi "Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor" (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

7. Projektvendimi "Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë" (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

8. Projektvendimi "Për zgjedhjen e një anëtarit të Bordit të ERE-s" (neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë, me shumicë të thjeshtë)

Raporti i Komisionit përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Koha e votimit

9. Projektvendimi "Për zgjedhjen e kryetarit të Bordit të ERE-s" (neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë me shumicë të thjeshtë)

Raporti i Komisionit përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Koha e votimit

10. Projektvendimi "Për miratimin e kandidaturave për pozicionet e komisionerëve pranë Avokatit të Popullit" (neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë, me shumicë të thjeshtë)

Raporti i Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Koha e votimit

11. Për votim: projektvendimi "Për zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar" (neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë, me shumicë të thjeshtë)

12. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Të futet media në sallë!

Seancën plenare të ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Njoftoj se në rendin e ditës së datës 21 shkurt ishin parashikuar edhe dy çështjet e mëposhtme: interpelancë urgjente me ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, kërkuar nga deputeti i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, zoti Petrit Vasili, si dhe projektvendimi "Për ngritjen e komisionit hetimor "Për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, gjatë periudhës 1 janar 2014 – 1 janar 2018, përfshirë edhe çështjen për të cilën prokuroria po heton zotin Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm".

Duke qenë se propozues të këtyre çështjeve ishin deputetët e opozitës parlamentare, të cilët tashmë kanë dhënë dorëheqjen nga mandati i deputetit, këto çështje hiqen automatikisht nga rendi i ditës, si dhe nga punimet e Kuvendit.

Ka ndonjë vërejtje për procesverbalet e seancave të datave 7 dhe 14 shkurt? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se në mbështetje të nenit 71, pika 2, germa "b" të Kushtetutës, kanë dhënë dorëheqjen nga mandatati deputetët e mëposhtëm:

Nga Partia Demokratike deputetët: Agron Shehaj, Albana Vokshi, Aldo Bumçi, Andon

Froka, Astrit Veliaj, Bardh Spahia, Dhurata Çupi Tyli, Edi Paloka, Edmond Spaho, Endri Hasa, Enkelejd Alibeaj, Ervin Salianji, Flamur Noka, Florjon Mima, Genc Pollo, Gent Strazimiri, Grida Shqina, Halim Kosova, Izmira Ulqinaku, Jorida Tabaku, Klevis Balliu, Lorenc Luka, Luan Baçi, Luçiano Boçi, Lulzim Basha, Oerd Bylykbashi, Romeo Gurakuqi, Sali Berisha, Tritan Shehu, Valentina Duka, Xhemal Gjunksi, Orjola Pampuri, Fatmir Mediu, Fatbardha Kadiu, Lindita Metaliaj, Nadire Meçorapaj, Hekuran Hoxhalli, Isuf Çelaj, Dashamir Shehi dhe Vangjel Dule.

Nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim deputetët: Agron Çela, Edmond Haxhinasto, Edmond Panariti, Endrit Braimllari, Florda Kërpaçi, Kejdi Mehmetaj, Klajda Gjoshaj, Luan Rama, Monika Kryemadhi, Nasip Naço, Nora Malaj, Petrit Vasili, Përparim Spahiu, Shezai Rrokaj, Vangjel Tavo, Viktor Tushaj dhe Silva Caka.

Në zbatim të Kodit Zgjedhor, Kuvendi i Shqipërisë për dorëzimin e këtyre mandateteve ka njoftuar organin kompetent për të ndjekur procedurat e mëtejshme sipas këtij Kodi.

Nga Këshilli i Ministrave janë depozituar 6 projektligje, njëri prej të cilëve është kërkuar me procedurë të përshpejtuar shqyrtimi. Votimi i projektvendimit do të bëhet së bashku me çështjet e tjera të rendit të ditës.

Ndërkohë, njoftoj se deputeti Vullnet Sinaj ka tërhequr nismën e tij “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për ndihmën dhe mbrojtjen shoqërore””.

Nga institucionet e krijuara me ligj, Komisioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka depozituar raportin vjetor të 2018-ës.

Gjithashtu, ju njoftoj se deputeti Dritan Bici, me kërkesë të tij dhe me vendim të grupit parlamentar, është bërë anëtar i Grupit Parlamentar të PS-së. Materialet do t'i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit në internet, në e-parlament.

Fillojmë me çështjen e parë të rendit të ditës, me projektligjin “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”.

Sipas Rregullores, a ka dëshirë ta marrë fjalën nismëtar, ministri i Bujqësisë?

Për këtë çështje janë regjistruar për të marrë fjalën deputetët: Senida Mesi, Edmond Leka dhe në emër të grupit Robert Bitri.

Fjala për ju, zoti Ministër.

Bledar Çuçi – Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji që kemi sjellë në Kuvend ka një rëndësi të madhe, sepse i hap rrugë promovimit të produkteve tradicionale dhe lokale. Shqipëria ka plot produkte të tilla, por deri tani nuk ka pasur një kuadër ligjor të plotë për t'i promovuar dhe mbrojtur ato.

Fokusi kryesor i këtij projektligji është vlerësimi i karakteristikave unike të produkteve shqiptare, duke u mbështetur edhe në praktikën e vendeve të Bashkimit Europian. Gjithnjë e më shumë konsumatorët kanë nevojë për një identifikim të qartë të produktit që blejnë dhe të garantohen për cilësinë e tyre. Ata janë të ndjeshëm ndaj mënyrës tradicionale të prodhimit apo origjinës së produkteve që blejnë.

Në tregje konstatohet rritje e reputacionit të produkteve bujqësore dhe ushqimore tradicionale, për shkak se konsumatorët kanë rritur kërkesën për këto produkte, por, nga ana tjetër, edhe prodhuesit janë të interesuar të mbrojnë produktet e tyre nga imitimet apo mashtrimet që bëjnë abuzues të ndryshëm në treg.

Prodhuesit duan të përcjellin te konsumatorët karakteristikat e veçanta të produkteve të tyre. Sot në vendet e Bashkimit Europian janë regjistruar mbi 3400 produkte me një vlerë tregu prej 100 miliardë eurosh. Po cilat janë përfitimet që vijnë nga ky ligj? Sigurisht, miratimi i këtij ligji dhe paketa e akteve nënligjore, që do ta shoqërojnë, do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik rural, sidomos në sektorin e turizmit. Ndërtimi dhe zhvillimi i sistemeve të cilësisë do të bëjnë të mundur identifikimin, certifikimin, monitorimin dhe mbrojtjen në treg të produkteve që gëzojnë statusin e produkteve tradicionale ose me origjinë gjeografike të përcaktuar.

Deri më tani kuadri ligjor për markat e cilësisë është rregulluar pjesërisht dhe kjo u bë me ligjin për pronësinë industriale, por ky ligj nuk është i mjaftueshëm, pasi ka mangësi në aspektin administrativ e sidomos në atë institucional. Mjafton të përmendim faktin që deri më sot kemi regjistruar vetëm 11 produkte të tilla, veçojmë këtu: jufkat dibrane apo mjaltin e gështenjës së Tropojës, mjaltin e gështenjës së Reçit, mishin e dhisë së Hasit e të tjerë. Lista e

produkteve të paregjistruara është shumë më e gjatë.

Projektligji për skemat e cilësisë, që do të votojmë sot, plotëson një boshllëk ligjor dhe vendos njëkohësisht kuadrin normativ dhe administrativ për njohjen dhe certifikimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore në tri sisteme kryesore të përafruara me ato të vendeve të Bashkimit Europian. Këto janë: emërtim i origjinës së mbrojtur, tregues gjeografik i mbrojtur dhe specialitet tradicional i garantuar.

Pas miratimit të këtij projektligji, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të ngrihet struktura përkatëse, ku përfshihen komisioni dhe struktura përgjegjëse, që do të plotësojnë hallkat procedurale për regjistrimin e dy prej markave të cilësisë, përkatësisht: emërtimin e origjinës së mbrojtur dhe treguesin gjeografik të mbrojtur. Këto dy marka do të kenë bashkëpunim me Drejtorinë e Pronësisë Industriale, ndërsa për regjistrimin e produkteve tradicionale e gjithë procedura do të zhvillohet brenda Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Risi e këtij projektligji është edhe parashikimi në skemën europiane të cilësisë, duke rritur në këtë mënyrë mundësinë e eksportit të produkteve në këto vende, veçanërisht kjo është e mundur për produktet e një cilësie të lartë, si vaji i ullirit, për varietet autoktone, sidomos mishi i imët për racat autoktone, rakia, produktet e qumështit, agrumet, perimet e të tjera.

Regjistrimi i produkteve, si pjesë e markave të cilësisë, garanton promovimin në tregun vendas dhe të huaj nëpërmjet sistemit të logove të njohura ndërkombëtarisht, që vendosen në etiketën e produktit. Është për t'u theksuar se, përveç vlerës së rritur në treg, nëpërmjet aplikimit të logove, markat e cilësisë garantojnë edhe mbrojtjen ligjore nga konkurrenca e pandershme dhe mashtrimi me produktet në treg.

Projektligji ngarkon Autoritetin Kombëtar të Ushqimit të realizojë kontrollet zyrtare të produkteve, që mbartin logon e markave të cilësisë, duke garantuar që produktet e certifikuar nuk janë të falsifikuara dhe janë në përputhje me standardin e kërkuar për të cilin janë certifikuar.

Ky projektligj vjen edhe si zbatim i Planit Kombëtar të Integritimit Europian dhe

Objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020. Në rekomandimet e progresraportit të Bashkimit Europian për vitin 2018 trajtohet në mënyrë specifike politika e cilësisë në Shqipëri, si pjesë e kapitullit të 11 të negociatave "Bujqësia dhe zhvillimi rural", ku identifikohet si nevojë ndërtimi i kuadrit ligjor për sistemet e cilësisë, pikërisht ligji që pritet të miratohet sot.

Ky projektligj, gjithashtu, do të krijojë edhe mundësinë e zhvillimit të produkteve tradicionale nëpërmjet politikave mbështetëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, qoftë me skemën kombëtare të mbështetjes, qoftë nëpërmjet programit "IPARD". Qëllimi final është një shportë e produkteve shqiptare të certifikuar me marka të cilësisë, që do t'i mbështesim nëpërmjet promovimit të dedikuar brenda dhe jashtë vendit.

Ky projektligj jep një kontribut të çmueshëm në këtë drejtim dhe vjen në përmbushje të programit të qeverisë, ndaj, të dashur deputetë, ju ftoj ta miratojmë pa asnjë hezitim.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjala për zonjën Mesi. Të përgatitet zoti Leka dhe më pas zoti Robert Bitri, në emër të grupit.

Senida Mesi – Përsëritet të gjithëve!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj, që vjen si nismë e qeverisë shqiptare, ka elemente shumë të rëndësishme dhe detyrime që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit.

Dispozitat e këtij projektligji rregullojnë konkurrencën e drejtë për fermerët shqiptarë, japin garancinë e nevojshme për konsumatorin në lidhje me produktet e konsumit ushqimor, si një mundësi e mirë për ekonominë shqiptare që, nëpërmjet certifikimit të produkteve blegtorale, bujqësore dhe ushqimore të hapen kufijtë e këtyre produkteve edhe për eksport në vendet e Bashkimit Europian.

Projektligji ka për qëllim përcaktimin e rregullave për funksionimin e sistemit të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, duke i klasifikuar apo duke i emërtuar ato si specialitet tradicional i garantuar. Në këtë mënyrë u bë

vlerësimi i aplikimeve për regjistrimin e kësaj emërtese, verifikimi i përputhshmërisë së specifikimit të produktit me kërkesat për regjistrimin e emërtimeve të origjinës, si dhe të treguesve gjeografikë për produktet bujqësore dhe ushqimore, verifikimi i përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara, si dhe kryerja e kontrolleve zyrtare për të verifikuar përputhshmërinë e produkteve bujqësore ushqimore të regjistruara.

Në lidhje me atë që është trajtuar edhe në Komisionin Parlamentar të Integritetit European, ky ligj është konform aspekteve procedurale të përafrimit me nenin 70 të MSA-së, që njeh rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European; me nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, si dhe me nenin 68, pika 2, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që parashikon se projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e Bashkimit European.

Sigurisht, ky projektligj është në përputhje edhe me objektivat strategjike dhe prioritetet e parashikuara në kapitullin XI “Bujqësia dhe zhvillimi rural” të Planit Kombëtar për Integrimin European 2017-2020.

Në lidhje me legjislacionin dytësor të Bashkimit European, ky projektligj përafrohet me Rregulloren e Bashkimit European nr. 151/2012 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 21 nëntor 2012 “Mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”, e ndryshuar”.”.

Sikur të ishin marrë parasysh të gjitha ato që thashë më sipër, si edhe ato që përmendi zoti ministër, sepse një projektligj i tillë jo vetëm është shumë i rëndësishëm dhe është një hap më tutje jo thjesht për përafrimin e legjislacionit dhe kapitullin e veçantë për bujqësinë, kapitulli XI, por tregon edhe një herë gatishmërinë jo vetëm të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të qeverisë shqiptare për të marrë përsipër një rol shumë të rëndësishëm, një rol ligjor, një rol kushtetues, për të cilin bashkëqytetarët tanë na e kanë besuar të qeverisim.

Fakti që sot jemi këtu si maxhorancë për të vazhduar më tutje me gjithë axhendën tonë

politike, dhe jo vetëm, por edhe atë parlamentare dhe ekzekutive, tregon edhe një herë përgjegjshmërinë tonë dhe faktin që jemi këtu për të punuar dhe për të bashkëqeverisur me çdo qytetar të zakonshëm të këtij vendi.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Mesi!

Fjalën e ka zoti Edmond Leka.

Edmond Leka – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore” ka për qëllim të përcaktojë rregullat për funksionimin e sistemit të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, si dhe detyrat dhe kompetencat e organeve përgjegjëse për vlerësimin e aplikimeve për regjistrimin e emërtimeve “specialitet tradicional i garantuar”, verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet e produktit për kërkesat, për regjistrimin e emërtimeve të origjinës dhe të treguesve gjeografikë për produktet bujqësore dhe ushqimore; verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara para vendosjes së tyre në treg, kryerjen e kontrolleve zyrtare për të verifikuar përputhshmërinë e produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara me kërkesat e përcaktuara në këtë projektligj, si dhe vlerësimin e aplikimeve për skemat e tjera të cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore, të cilat nuk janë pjesë e këtyre tri skemave.

Projektligji do të zbatohet për produktet bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor, të cilat do të përcaktohen sipas listës që do të miratohet me urdhër të ministrit. Të gjitha produktet bujqësore dhe ushqimore, të cilat afrojnë karakteristika të veçanta tradicionale dhe vlerë të shtuar në mënyrën e prodhimit dhe të përpunimit të tyre, do të regjistrohen si emërtime cilësie ose skema të tjera cilësie.

Përparësitë kryesore të projektligjit lidhen me qëllimin për të ndihmuar prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore të reklamojnë cilësinë e produkteve të tyre te konsumatorët; për të siguruar konkurrencë të drejtë për fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristika dhe tregues të vlerës së shtuar të cilësisë; për të dhënë informacionin e nevojshëm për konsumatorin për cilësinë e këtyre produkteve dhe për të siguruar integritetin e tregut, për të

vlerësuar dhe regjistruar specifikit tradicionale të garantuara; për të kryer vlerësimin në substancë të produkteve bujqësore dhe ushqimore; për të mundësuar hartimin dhe publikimin e regjistrimit dhe të produkteve pjesë të skemave të tjera të cilësisë; për të rritur kërkesën në drejtim të cilësisë së produkteve tradicionale dhe shumëllojshmërisë së produkteve bujqësore; për të kontribuar dhe plotësuar politikat e përcaktuara në skemat e zhvillimit rural bazuar në politikat e përbashkëta europiane; për të nxitur zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara, si dhe të zonave malore.

Eksperiencia e specialistëve që do të merren me këtë proces përbën një sfidë për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural. Efektet e pritshme të këtij projektligji lidhen me rritjen e nivelit të jetesës, zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, si dhe me shumëllojshmërinë e prodhimit bujqësor. Me anë të këtij projektligji propozohet hartimi i një baze për vlerësimin dhe regjistrimin e të gjitha produkteve bujqësore dhe ushqimore që nuk janë pjesë e tri skemave, por që plotësojnë kushtet që lidhen me karakterin specifik të prodhimit tradicional. Verifikimi i përputhshmërisë me specifikit e produktit dhe kontrollet zyrtare përcakton dhe detajon në mënyrë të qartë autoritetet për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve me karakteristika specifike, trupat e certifikimit, miratimin dhe auditimin e tyre, kontrollet zyrtare, raportimin, si dhe procedurat në rastet e parregullsive. Skema të tjera cilësie përcaktojnë kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë produktet bujqësore dhe ushqimore për të qenë pjesë e këtyre skemave. Disa nga këto skema mund të jenë produkte tipike, produktet e zonave malore e të tjera.

Gjithashtu, përcaktohet ngritja e një komiteti apo këshilli pranë ministrisë për të vlerësuar dhe për të dhënë mendime për produktet bujqësore dhe ushqimore, si dhe mbrojtja kombëtare dhe e drejta e përdorimit. Shpenzimet e mundshme afërsisht do të jenë 3,1 milionë lekë, ndërsa të ardhurat mund të arrijnë dyfishin e tyre. Certifikimi dhe skemat e cilësisë së produkteve ushqimore dhe bujqësore do të përballen edhe me problemin e madh të imitacionit, por edhe me emërtimet e ngjashme dhe kjo do të jetë sfida më e madhe e Ministrisë së Bujqësisë për evidentimin dhe luftën ndaj këtyre fenomeneve.

Ky projektligj shman të gjitha burokracitë që e pengojnë biznesin shqiptar të prodhimit tradicional në marrjen e certifikatave dhe regjistrimin e produkteve të tyre në vendet e Bashkimit European. Konkretisht, vetëm në qarkun e Vlorës bizneset që kultivojnë dhe tregtojnë produkte tradicionale të zonës në vendet e Bashkimit European kanë vuajtur vite të tëra për certifikimin e produkteve të tyre tradicionale të zonës. Produkte si vaji i ullirit, mjalti, kripa industriale dhe ajo e jonizuar, kocja e Karaburunit, e kanë gjetur veten në tregun e Bashkimit European si produkte të një cilësie shumë të lartë. Produktet e kripës “Alb Sale”, të peshkut “Alba Adriatika”, vaji i ullirit “Musai”, vaji i Kaninës, ai i Dhërmiut, i Borshit tregtohen sot me sukses në Itali, Gjermani, Zvicër e deri në Amerikë e Kinë. Por certifikimi i këtyre produkteve ka kërkuar një kohë të gjatë dhe kosto të lartë financiare. Në disa raste shumë biznese, edhe pse të pajisura me certifikime të standardeve të larta, bien pre e kontrolleve rutinë të AKU-së, e cila në shumë raste nuk ka personel të trajnuar për njohjen e këtyre certifikimeve, prandaj del si nevojë parësore edhe trajnimi dhe kualifikimi i këtyre punonjësve që ushtrojnë kontrolle mbi cilësinë dhe certifikimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore. Përafrimi i standardeve të Bashkimit European me cilësinë e produkteve të ushqimit dhe të bujqësisë është sfida më e madhe e Ministrisë së Bujqësisë.

I ftoj gjithë kolegët ta votojmë këtë projektligj!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Në emër të Grupit Parlamentar fjalën e ka zoti Bitri.

Robert Bitri – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Ky projektligj është në përputhje me programin e qeverisë dhe me politikat e Ministrisë së Bujqësisë. Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin analitik të projekteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2019, por u paraqit duke qenë mjaft i rëndësishëm dhe si detyrim i rekomandimeve të BE-së. Rezultatet e miratimit të këtij projektakti janë përcaktimi i rregullave për funksionimin e sistemit të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, kompetencave të organeve përgjegjëse për vlerësimin dhe certifikimin e produkteve nën emërtimin STG; të sigurojë

konkurrencën e drejtë për fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristikat dhe treguesit e vlerës së shtuar të cilësisë dhe rritjen e kontributeve në politikat e përcaktuara në skemat e zhvillimit rural bazuar në politikat e përbashkëta europiane për të nxitur zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara dhe të zonave malore.

Politikat dhe skemat e cilësisë kanë si qëllim mbrojtjen e emrit të një produkti specifik për të promovuar karakteristikat unike të tij, të cilat lidhen me origjinën gjeografike të këtij produkti, si dhe me pjesën tradicionale të tij. Këto skema janë bërë të domosdoshme, pasi qytetarët dhe konsumatorët kërkojnë gjithnjë e më shumë edhe cilësi përveç ushqimeve tradicionale. Prodhuesit mund të vazhdojnë të prodhojnë një produkt cilësor vetëm nëse ata shpërblehen siç duhet për përpjekjet e tyre. Përdorimi i këtyre skemave për prodhuesit si shpërblim për prodhimin e një game produktesh me cilësi nxit ekonominë rurale, sidomos në zonat më pak të favorizuara siç janë ato malore, si dhe shumë rajone ku sektori bujqësor zë një vend të rëndësishëm në ekonomi dhe ku kostot e prodhimit të këtyre produkteve janë të larta.

Politikat e Bashkimit European në këtë fushë janë përfshirë në Rregulloren e Bashkimit European nr. 1151 të vitit 2012 të Parlamentit European dhe të Këshillit. Rregullimi i kësaj fushe ka filluar që nga viti 1992 me Rregulloren e ECS me nr. 2081 të vitit 1992 dhe më pas me Rregulloren nr. 509 të vitit 2006 dhe me Rregulloren nr. 510 të vitit 2006 dhe në fund me Rregulloren nr. 1151 të vitit 2012, e cila është në fuqi edhe sot.

Me anë të këtij projektligji propozohet hartimi i një baze për vlerësimin dhe regjistrimin e specialiteteve tradicionale të garantuara, të quajtura STG, për vlerësimin e emërtimeve të origjinës, të quajtura EO dhe treguesit gjeografikë TGJ, si dhe vlerësimin dhe regjistrimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore që nuk janë pjesë e tri skemave, por që plotësojnë kushtet që lidhen me karakteristikat specifike të prodhimit dhe të traditës.

Objektivat kryesorë të këtij projektligji synojnë të ndihmojnë prodhuesit që të reklamojnë cilësinë e produkteve të tyre te

konsumatori, për të siguruar konkurrencë të drejtë për fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristika dhe tregues të vlerës së shtuar të cilësisë, për të dhënë informacione të nevojshme për konsumatorin për cilësinë e këtyre produkteve dhe për të siguruar integritetin e tregut; për të vlerësuar dhe regjistruar STG-të dhe për të kryer vlerësimin në substancë të EO-ve dhe të TGJ-ve për produktet bujqësore dhe ushqimore; për të mundësuar hartimin dhe publikimin e regjistrimeve edhe për produktet pjesë të skemave të tjera të cilësisë; për të rritur kërkesën në drejtimin të cilësisë së produkteve tradicionale dhe shumëllojshmërisë së prodhimeve bujqësore; për të nxitur zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara dhe të zonave malore.

Rezultatet e këtij miratimi dhe të këtij projektakti janë:

Përcaktimi i rregullave për funksionimin e sistemit të cilësive të produkteve bujqësore dhe ushqimore;

kompetenca e organeve përgjegjëse për të vlerësuar, regjistruar dhe certifikuar produktet nën emërtimin e STG-ve;

sigurimi i konkurrencës së drejtë për fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristika dhe tregues të vlerës së shtuar të cilësisë;

dhënia e informacioneve të nevojshme për konsumatorin, për cilësinë e këtyre produkteve dhe për të siguruar integritetin e tregut;

publikimi i regjistrimit për STG-në dhe produktet pjesë e skemave të tjera të cilësisë, rritja e kërkesës në drejtim të cilësisë së produkteve tradicionale dhe diversifikimin e prodhimit bujqësor;

kontributi në politikën e përcaktuar në skemat e zhvillimit rural bazuar në politikat e përbashkëta europiane për të nxitur zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara dhe të zonave malore.

Përfituesit kryesorë të projektligjit dhe të projektit janë konsumatorët dhe grupet e prodhuesve që punojnë me produktet bujqësore dhe ushqimore. Përfituesit në bazë të këtij projektligji, do të përcaktohen sipas listës që do të miratohet me urdhër të ministrit. Të gjitha produktet bujqësore dhe ushqimore, të cilat ofrojnë karakteristika të veçanta tradicionale dhe

me vlerë të shtuar në mënyrën e prodhimit dhe përpunimit të tyre, do të regjistrohen si emërtime cilësore: STG, EOM dhe TGJM dhe sipas skemave të tjera të cilësisë.

Gjatë shqyrtimit nën për nën të projektligjit u pa e nevojshme ndërhyrja për përmirësimin e këtij ligji. Për këtë ne si komision e miratuam dhe vendosëm t'ua kalojmë në seancën e sotme, prandaj ju bëj ftesë ta miratojmë këtë ligj, sepse nëpërmjet tij ne do të sigurojmë më shumë pavarësi, do t'i japim një vlerë të shtuar zhvillimit të turizmit në Shqipëri dhe do të mburremi me prodhimet tona shqiptare "Made in Albania".

Faleminderit!

Gramoz Ruçi- Faleminderit, zoti Bitri!

Këtu mbyllet diskutimi për këtë projektligj.

Vazhdojmë me dy projektligjet e tjera: "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore nga ish-ndërmarrjet bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar" dhe "Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë /07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë për tokën bujqësore", të ndryshuar".

Fjala për zotin Beqaj.

Ilir Beqaj – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Në fakt, këto janë dy nisma të kolegut tonë, deputetit Erion Braçe, përmes të cilave mund të zgjidhim një çështje të rëndësishme, siç është marrja e certifikatës për tokën bujqësore.

Sigurisht, kolegu Braçe ka marrë shtysë nga problematika e një zone të caktuar të vendit, ku ai kryen funksionin politik dhe shtetëror të deputetit, por, në fakt, këto problematika shtrihen edhe në vende të tjera.

Nga informacionet paraprake gjatë diskutimeve në komision, por edhe nga ato që vijnë nga Ministria e Bujqësisë, bëhet fjalë për rreth 3500 familje, të cilat në periudhën gusht-shtator 1991 nuk kanë qenë në atë kohë të rregulluara me lejet e qëndrimit ose, siç e quanim dikur pasaportizim.

Në Kuvend çështjet e bujqësisë janë me interes, sepse bujqësia vazhdon të jetë një nga faktorët kryesorë të ekonomisë sonë, e cila jep 1/5-n e produktit të brendshëm bruto. Me gjithë zhvillimet 30-vjeçare demokratike, ende në fshat

vazhdojnë të jetojnë rreth 40% e popullsisë, por ajo që duhet thënë është se ne kemi ende potenciale të pashfrytëzuara për ta zhvilluar edhe më tej bujqësinë jo thjesht si jetesë në fshat, jo vetëm si mbijetesë, jo si instrument i zbutjes së varfërisë, por si një instrument i mirëfilltë ekonomik. Në 5 vjet e gjysmë ne kemi bërë ndërhyrje të rëndësishme në bujqësi, të drejtpërdrejta ose edhe të tërthorta, të cilat kanë filluar të japin frytet e tyre.

Elementi më i prekshëm është ndryshimi i raportit import-eksport në bujqësi, pra si ishte në vitin 2013 dhe si u mbyll në vitin 2018. Nëse eksportet bujqësore në vitet 2015, 2016, 2017, 2018 janë rritur në vlera të konsiderueshme në më shumë se 2 pikë përqindje, vitin e kaluar importet u rritën me 2-3 %. Kjo ka sjellë që jo vetëm raporti import-eksport në bujqësi të zbresë në rreth 3,2, por ka ndikuar edhe në forcimin e bilancit tregtar në vend, gjë që bashkë me kontributin e turizmit ka krijuar qëndrueshmëri të lekut prej tashmë më shumë se 1 viti. Ndërkohë, që ne këtu si Kuvend me skemat tona mbështetëse kemi miratuar lehtësira të vazhdueshme fiskale, pikërisht për të zhvilluar bujqësinë, agropërpunimin, agroturizmin, të gjithë kemi pranuar që për të pasur akses dhe përfitim në të gjitha këto skema duhet titulli i pronësisë. Prandaj ky ligj sot është i rëndësishëm edhe për këtë arsye. Pas 20 vjet premtimesh të forcave të ndryshme politike, TVSH-në e inputeve bujqësore nga 1 janari i këtij viti e kemi zero, TVSH-ja e mekanikës bujqësore është e përjashtuar. Nëse deri vjet lejonim vetëm fermerin të importonte me TVSH të përjashtuar të makinerive bujqësore, nga janari i këtij viti edhe tregtarët, që i importojnë dhe pastaj i tregtojnë me shumicë këto pajisje, i importojnë me TVSH të përjashtuar.

Ne kemi ulur tatimin e fitimit në nivele shumë të ulta për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, me qëllim që me marrjen e certifikatës së pronësisë fermerët të mund të bashkohen për të përfutur më shumë nga qeveria, për të prodhuar më shumë, për të qenë të mbrojtur më shumë nga luhatjet e tregut dhe, sigurisht që të mund të imponohen edhe më shumë para grumbulluesve ose grosistëve.

Është evidente që ne në 5 vjet kemi bërë investime serioze për vaditje dhe kullim. 120 mijë hektarë kishim nën vaditje në shtator të

vitit 2013, arritëm që në shtator të vitit 2017 të kishim 225 mijë. Gjithashtu, me investimet e filluara vjet me financime të buxhetit të brendshëm, por edhe me disa financime të huaja këtë vit, do të kemi skema të reja në tri zona të rëndësishme të vendit, të cilat brenda këtij viti do të arrijnë në rreth 255 mijë hektarë nga 300 mijë hektarë potencialë që Shqipëria mund të vaditë.

Ndërhyrje të rëndësishme janë bërë edhe për kullimin, në mënyrë që të minimizohen risqet nga përmbytjet e sezonit të dimrit. Ndërkohë, vit pas viti, kemi mbështetur direkt nga buxheti skemat e mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimit rural, madje ky është viti i parë që kemi në dispozicion rreth 90 milionë euro me financime edhe të Bashkimit Europian. Thirrja e parë është mbyllur më 30 janar. Sigurisht, ka pasur interes të madh dhe fakt është që janë bërë tri herë më shumë aplikime se në skemat e mëparshme, por do të duhet të presim rezultatet e aplikimeve të para për të parë çfarë është e nevojshme për të përmirësuar, për të modifikuar, qoftë në zhvillimin e prodhimit bujqësor, në rritjen e kapaciteteve në blegtori, në agropërpunimin bujqësor dhe blegtoral, por edhe në skemat e peshkimit dhe agroturizmit.

Ndërkohë, gjatë ditëve të kaluara, po në funksion të mbështetjes së atyre që duan të bëjnë biznes në Shqipëri, brenda programit të përgjithshëm të asaj që ne e kemi quajtur “deregulim”, ka pësuar lehtësira edhe importimi i inpueteve bujqësore, edhe korridori i gjelbër që funksionon për eksportin e produkteve tona bujqësore, të cilat kanë zgjeruar jo vetëm gjeografinë e vendeve ku shkojnë, kanë zgjeruar larminë e produkteve bujqësore, që ne prodhojmë nga toka jonë, por, gjithashtu, edhe ciklin dhe sezonin kur prodhohet.

Këto dy projektligje, përveçse duhen mbështetur për atë që zgjidhin, bëjnë një hap të pjesshëm në zgjidhjen e plotë dhe definitive, që ne kemi marrë përsipër të bëjmë me dy ligjet kryesore të reformës së pronës, për Agjencinë Qendrore të Trajtimit të Pronës dhe për mbylljen e procesit tranzitor të zgjidhjes së problemit të pronës në Shqipëri.

Zgjidhja e problemit të pronës qoftë në fshat, qoftë në qytet është një premisë, madje jemi të vonuar, sepse shumë investitorë që duan të investojnë në bujqësi, agropërpunim, turizëm ose fusha të tjera, problemin e pronësisë e kanë

pasur një nga vështirësitë dhe një nga pengesat kryesore, për të mos lënë mënjanë pastaj edhe të gjitha shqetësimet sociale dhe jetësore. Në fakt, mishmashi me pronat ka sjellë në Shqipëri fatalitete që kalojnë edhe të vrarët e Luftës së Dytë Botërore.

Unë përshëndes kolegun Braçe për nismën! Duke besuar se flas edhe në emrin tuaj, mendoj që kjo nismë duhet mbështetur me votë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bledar Çuçi

Bledar Çuçi - Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Një falënderim kam edhe për kolegun Beqaj që bëri një përshkrim të të gjithë paketës subvencionuese dhe lehtësuese që qeveria ka bërë për sektorin e rëndësishëm të bujqësisë.

Unë do të doja në mënyrë shteruese t’u shpjegoja shqiptarëve, që janë të interesuar si përfitues të drejtpërdrejtë të ndryshimeve ligjore që do të miratojmë sot, si lidhet ky projektligj me strategjinë që ne kemi për trajtimin e tokës bujqësore në Shqipëri.

Së pari, ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me shtyrjen e afatit të procesit të plotësimit të titujve të pronësisë për tokën bujqësore deri në 31 dhjetor 2019. Për të gjithë ata që nuk kanë mundur dot të bëjnë këtë plotësim me procesin që qeveria ndërtoi në bashkëpunim me bashkitë dhe për të mos i diskriminuar ata pikërisht në përfitimin që duhet të kenë për të kaluar në pronësi tokën bujqësore, ne e shtymë këtë afat deri më 31 dhjetor të vitit 2019.

Së dyti, konsiston në shtyrjen e afatit të shqyrtimit të vlefshmërisë së titujve të pronësisë për tokën bujqësore nga komisionet vendore pranë prefektëve deri më 31 dhjetor të vitit 2019.

Së treti, dhe kjo është shumë e rëndësishme, zgjerimi i rrethit të subjekteve përfituese të tokës bujqësore në pronësi. Me ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve” i ndryshuar” u jepet mundësia edhe familjeve bujqësore, pjesëtarët e të cilave kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore, por me gjendje civile nuk kanë qenë banorë më 01.08.1991. Ky kusht, nëse nuk plotësohet, përbënte pengesë në

legjislacionin aktual për t'u pajisur me tokë bujqësore.

Pra, kjo kategori do të plotësohet me titullin e pronësisë për tokën bujqësore, të cilën e përdor faktikisht, por që juridikisht deri sot nuk kishit hapësirë ligjore për ta trajtuar si tokë ose për ta marrë si akt të marrjes së tokës në pronësi.

Së katërti, në lidhje me subjektet që kanë tokë në përdorim në territoret e ish-kooperativave, parashikohet përfitimi i pronësisë së tokës, që e ka në aktet e përdorimit, gjithmonë me kushtin që ta përdorin tokën.

Në legjislacionin e kohës nuk dilte qartë nëse subjektet, të cilat e kanë përfutur tokën në përdorim dhe jo në pronësi në territoret e ish-kooperativave (këto kanë qenë familje që banonin në fshat, por nuk punonin në kooperativë), mund të pajiseshin me aktin e marrjes së tokës në pronësi. Pra, kjo gjë nuk ka qenë e qartë deri më sot. Pikërisht këto ndryshime sqarojnë këtë status, duke u dhënë atyre të drejtën që atë tokë, që faktikisht e përdornin, ta kthejnë në pronësi.

Disa bashki e kanë trajtuar këtë çështje, sepse kanë gjetur një hapësirë ligjore, dhe ua kanë kaluar tokën, por, gjithsesi, legjislacioni nuk ka qenë i plotë. Përfundimisht, në interpretim të këtij ligji, legjislacioni plotësohet dhe kjo kategori e përfiton tokën në pronësi.

Dy risitë që ka ligji i parë janë: verifikimi i ligjshmërisë së titujve të pronësisë për tokën bujqësore në territoret e ish-kooperativës bujqësore dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore. Këtu institucionet përgjegjëse do të jenë komisionet vendore pranë 12 prefekturave në të gjithë vendin. Risia e dytë është plotësimi i titujve të pronësisë për tokat bujqësore në ish-kooperativat bujqësore. Këtu institucion përgjegjës do të jetë bashkia në territorin e së cilës ndodhet toka.

Ligji i dytë konsiston në plotësimin e titujve të pronësisë për tokat bujqësore në ish-ndërmarrjet bujqësore. Këtu institucioni përgjegjës do të jetë bashkia në territorin e së cilës ndodhet toka. Pra, siç e shikoni, me këto dy ndryshime ne po tentojmë të rregullojmë juridikisht një situatë të paqartë, që ka pasur trajtimi i tokës bujqësore për sa i përket kategorisë që ka përfutur apo nuk ka mundur të përfutojë, por e ka punuar faktikisht pronën në fshat. Përkundër këtij fakti dua ta informoj parlamentin për mënyrën se si i kanë trajtuar

ministrat e mëparshëm tokat bujqësore për të cilat kanë qenë përgjegjës për administrimin e tyre. Në fakt, është një fond prej 19 mijë e 100 hektarësh, që administrohet nga ministri i Bujqësisë, si tokë bujqësore sot në Shqipëri, dhe nga këto ndër vite janë dhënë me kontrata rreth 3500 hektarë, por 1890 hektarë, më shumë se gjysma, nuk janë punuar nga qiramarrësit për arsye të ndryshme.

Dua të falënderoj edhe paraardhësin tim, i cili ka bërë një punë shumë të mirë në lidhje me evidentimin e situatës dhe shkaqeve që kanë sjellë këtë situatë! Pavarësisht se presupozohet që qeveria dhe ministri i Bujqësisë e kanë pasur në vëmendje që i gjithë fondi i tokave bujqësore t'u jepet atyre që mund ta kthejnë në një potencial prodhimi, por deri më sot ka rezultuar një dështim për më shumë se 50% të tokave që janë dhënë me qira.

Nga auditimet e grupit të kontrollit dhe nga KLSH-ja, e cila ka bërë kontrolle për 48 kontrata të lëshuara nga ministri i Bujqësisë, ka rezultuar se mangësia kryesore ka qenë mungesa e transparencës. Pra, informacioni për tokat bujqësore në dispozicion për qiradhënie nuk ka qenë publik dhe i hapur. Tashmë ne e kemi ndryshuar këtë realitet, sepse tani janë të publikuara jo vetëm në *web site* –in e Ministrisë së Bujqësisë, por edhe te Gjeoportali.

Së dyti, ka qenë mosshlyerja e detyrimeve financiare nga qiramarrësit, një situatë flagrante, që ka çuar drejtpërdrejt në shkeljen e kontratës.

Raporti i KLSH-së ka zbuluar se për vitin 2017 janë rreth 69 milionë e 998 mijë lekë të pashlyera nga qiramarrësit në favor të ministrisë, por, mbi të gjitha, në mënyrë paradoksale, nuk ka pasur asnjë strukturë të destinuar për t'i monitoruar këto kontrata brenda ministrisë.

Pra, të gjitha këto kanë sjellë një situatë jo të kënaqshme për sa i takon trajtimin të tokës bujqësore edhe në aspektin legjislativ, që po mundohemi ta rregullojmë me këto dy ligje transitorë, më pas edhe me ligjin kuadër, që do ta sjellim për miratim besoj brenda 6 muajve në parlament, por edhe trajtimin të fondit të tokave bujqësore, që ministri i Bujqësisë i ka pasur në përgjegjësinë e administrimit.

Kështu, të nderuar kolegë, ju ftoj që ta miratojmë këtë ligj. Besoj se për deputetët që mbulojnë zonat rurale, por edhe për komunitetet

që banojnë në këto zona, ky do të jetë një lajm i mirë,

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Duke iu referuar asaj që tha zoti Beqaj, unë nuk e shikoj vetëm si një instrument ekonomik, por edhe si zgjidhjen e një problematike serioze, sociale dhe një reflektim ndaj një përvoje, që përpiqet të vendosë në vend një padrejtësi të shkaktuar ndër vite. Pa dyshim këtu ka meritë edhe zoti Braçe, i cili është shumë i vëmendshëm ndaj elektoratit në përgjithësi, sepse nëpërmjet këtyre ligjeve kjo problematikë do të zgjidhet përfundimisht.

Këto dy nisma kanë të bëjnë drejtpërdrejt me probleme konkrete, që lidhen me çështjen e pronësisë së tokës bujqësore dhe me proceset e zhvilluara në raport me të. Gjeografia e këtyre zonave shtrihet në rajonet rurale, ku deputetët e çdo partie janë ndeshur në vazhdimësi me probleme të këtij lloji. Me këto dy nisma kërkohet t'i jepet një zgjidhje sa më e mirë problematikës që haset në këto territore bujqësore.

Sikurse e ka theksuar edhe zoti Braçe, nuk bëhet fjalë për të ndarë apo rindarë tokën nga fillimi, pra nuk bëhet fjalë për të ndarë tokën, që sot është e lirë dhe që duhet t'ua vëmë në dispozicion familjeve bujqësore, qofshin këta edhe individë që merren me bujqësinë në fshat, por bëhet fjalë për tokë të ndarë, që është shoqëruar me aktin e marrjes së tokës në përdorim dhe që më herët, para viteve '90, ka qenë në administrimin e ndërmarrjeve bujqësore. Edhe një herë dua të theksoj se nuk bëhet fjalë për tokat e ndara me ligjin nr. 7501, por bëhet fjalë për tokat, që kanë qenë në administrimin e ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe që më pas i janë nënshtruar procesit të ndarjes për familjet bujqësore dhe për individët, që janë marrë me bujqësi në atë periudhë.

Propozimet e bëra në këto dy projektligje do të zgjidhin problemet për tri kategori të familjeve të zonave bujqësore:

Kategoria e parë ka të bëjë me ligjin themelor. Një familjar duhej të përfitonte tokë brenda datës 01.08.1991, që ishte vendosur si

kufi. Për këtë duhej të provohej që pasaportizimi në territor të ishte bërë para kësaj date. Ka raste që këto familje bujqësore janë vendosur fizikisht në këto territore para datës 01.08.1991, por kjo nuk është shoqëruar me pasaportizim të menjëhershëm për shkak të situatës jofunksionale të shtetit në atë kohë. Për këtë arsye këto familje janë pajisur me tokë nga komisionet e ndarjes së tokave në atë periudhë dhe e kanë marrë tokën sipas normës për frymë, sipas legjislacionit në fjalë, por toka e tyre ka mbetur në përdorim, sepse ligji ua ndalon apo ua kufizon marrjen e tokës në pronësi këtyre familjeve, që pasaportizimin e kanë marrë pas datës 1 gusht të vitit 1991.

Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë familjet bujqësore apo edhe individët, të cilët në momentin kur ka ndodhur procesi i regjistrimit të tokës, pas ndarjes, nuk kanë qenë në këtë territor, por kanë qenë në emigracion. Pra, ata nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, sepse mund të jenë zhvendosur brenda territorit për arsye nga më ndryshmet ose janë harruar fare gjatë procesit të regjistrimit të kësaj toke, por vendbanimin e përhershëm, natyrisht edhe pasaportizimin e kanë pasur në këto territore. Domethënë, me ligjin që është sot në fuqi, për shkak se kanë ndryshuar vendbanim në kohë të caktuara, këtyre familjeve, pavarësisht se e shfrytëzojnë atë tokë, nuk u jepet e drejta e ndjekjes së procedurës së marrjes së tokës në pronësi.

Kategoria e tretë ka të bëjë me familjet, që janë zhvendosur me vendim të Këshillit të Ministrave nga pjesë të ndryshme të territorit të vendit në brendësi të territoreve bujqësore, pra në tokat që janë administruar nga ish-ndërmarrjet bujqësore. Toka për ta është ndarë përsëri me normën për frymë, siç ka qenë përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, pavarësisht se u është dhënë mundësia që ta kalojnë tokën në pronësi, për arsye se kanë qenë në afatin e vendosur në ligj, që ka skaduar më 31 dhjetor të vitit 2018, të gjitha këto familje mund të humbasin të drejtën e marrjes së tokës në pronësi. Ndaj, në ligj ky afat propozohet që të shtyhet deri më 30 qershor të vitit 2019.

Mendoj se argumentet e paraqitura nga zoti Braçe janë shumë bindëse, sepse reflektojnë shqetësimet me situatën reale për këto tri grupe interesi, ndaj ju ftoj t'i votoni në tërësi këto projektligje.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Baraj!

Këtu përfundon edhe diskutimi i këtyre dy nismave: projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfutuesve”, të ndryshuar”, si dhe projektligji “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar”.

Kalojmë te dy projektvendime: “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Për të folur rreth këtyre projektvendimeve kanë regjistruar emrat deputetët: Klotilda Bushka, Taulant Balla, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Ermonela Felaj, Elisa Spiropali, Olta Xhaçka, Blerina Gjylameti, Eduard Shalsi. Në emër të grupit do të flasë deputeti Ulsi Manja.

Fjala është për zonjën Bushka.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Zonja Ministre, duhet ta kërkonit më parë fjalën!

Etilda Gjonaj – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pavarësisht përpjekjeve të pafundme të partive opozitare për bllokimin e reformës në drejtësi dhe bllokimin e rrugëtimit europian të Shqipërisë, sot Kuvendi i Shqipërisë vendos për një aspekt të rëndësishëm lidhur me institucionet e reja të sistemit të drejtësisë.

Miratimi i strukturës së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke iu afuar maksimalisht pritshmërisë së vetë këshillave për numrin e punonjësve dhe buxhetin për vitin 2019, është treguesi më i qartë i vullnetit politik të kësaj maxhorance për të ngritur një sistem drejtësie të fortë, të pavarur dhe me mundësitë maksimale për të ushtruar detyrën kushtetuese.

Dy këshillat sigurojnë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë për mbarrëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe sistemit të prokurorisë, duke garantuar kështu që pushteti gjyqësor të mos bjerë më në batakun e mëparshëm, por të jetë

gardiani i vlerave më të mira të shoqërisë shqiptare.

Me gjithë qëndrimin që kanë pasur qeveria dhe Partia Socialiste jemi angazhuar që zbatimi i reformës në drejtësi të jetë në interes të qytetarit, në interes të pasjes së një sistemi drejtësie, ku çdo qytetar është i barabartë përpara ligjit, pavarësisht pushtetit politik apo ekonomik që mund të ketë, pra të tejkalojë çdo llogari apo interes politik të çastit.

Unë jam e bindur që partitë politike opozitare janë jashtë kësaj sale, sepse po shohin dita-ditës ndërtimin e sistemit të ri të drejtësisë e pak nga pak po shkëputen fijet e pushtetit dhe kontrollit mbi sistemin e drejtësisë. Këtë e dëshmon qartë edhe mungesa e vullnetit të opozitës për të miratuar ndryshimet e dy ligjeve të paketës së reformës në drejtësi, që ende presin në Këshillin e Legjislacionit, në zbatim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e këshillave për të vënë përpara përgjegjësisë gjyqtarë dhe prokurorë për çdo veprim të paligjshëm dhe abuziv. Edhe në vitin 2018 opozita u bë pengësë kur vendosi të mos miratojë ndryshimet për hyrjen në Shkollën e Magjistraturës të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Mungesa e kandidatëve për një vit, të cilët duhet të ndiqnin Shkollën e Magjistraturës, i ka kushtuar shumë sistemit të drejtësisë. Por edhe kjo u superua me ngritjen e këshillave, të cilët, në përgjigje të kërkesës së Shkollës së Magjistraturës, miratuan 75 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë, që do të ndjekin shkollën në vitin akademik në vijim.

Garancitë procedurale të krijuara me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi dhe garancitë reale nëpërmjet mbështetjes financiare dhe infrastrukturore të vendosura në dispozicion nga qeveria dhe Kuvendi, janë treguesit më të mirë që reforma në drejtësi po prodhon rezultatet e saj më të mira.

Ne nuk e mbështesim reformën në drejtësi vetëm me këto mendime. Sigurimi i mbështetjes financiare dhe institucionale për burime njerëzore të institucioneve të reja të drejtësisë, të ngritura tashmë, është bërë realitet me miratimin e disa vendimeve shumë të rëndësishme gjatë vitit 2018, ku u plotësua struktura dhe u bë shtimi i pagës së komisionerëve dhe komisioneve të vetingut. Njëkohësisht po përgatisim edhe paketën për mbështetjen

financiare të gjyqtarëve dhe prokurorëve të SPAK-ut, duke rritur ndjeshëm pagën e tyre, si dhe nga ana tjetër mbështetjen financiare dhe logjistike të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ndryshimin e një sërë aktesh nënligjore, që kanë si qëllim futjen në skemën e sigurimeve suplementare dhe garantimin e një sërë të drejtash të tjera për anëtarët e sistemit të ri të drejtësisë. Falë kësaj mbështetjeje financiare, sistemi i ri i drejtësisë, veçanërisht SPAK-u, i cili në këtë moment është në procesin e ngritjes, do të shuajë një herë e mirë kulturën e pandëshkueshmërisë, duke hetuar të gjitha dosjet e korrupsionit, lidhjet me krimin e organizuar dhe duke dënuar çdo zyrtar e ish-zyrtar të lartë.

Nga tryezat e shumta që kam pasur me gjyqtarë dhe prokurorë është shprehur mirënjohja që më në fund magjistratët po marrin një shpërblim të denjë për punën dhe rolin që ata kanë në shoqëri.

Më lejoni të kujtoj që rreth 1 miliard lekë nga buxheti i shtetit i janë kushtuar skemës së re të pagave për gjyqtarët dhe prokurorët. Që nga 1 janari i vitit 2019 gjyqtarët, prokurorët dhe të gjithë ata që janë pjesë e sistemit të drejtësisë përfitojnë dyfishin e pagës në krahasim me pagën e mëparshme. Kjo është rritja më e madhe që mund të jetë bërë ndonjëherë në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Qeveria shqiptare dhe maxhoranca kanë treguar jo vetëm vullnet politik, por me veprime konkrete në mënyrë konsistente kanë përmbytur të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë në zbatim të reformës në drejtësi. Tashmë është radha e organeve të reja të sistemit të drejtësisë që t'u bëjnë ballë me sukses sfidave që kanë përpara, ashtu siç ka ndodhur në këta muajt e parë të veprimtarisë së tyre, me qëllim pasjen e një sistemi të ri të efektshëm të drejtësisë.

Të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj të votoni strukturat e këshillave të rinj, sepse këta këshilla do të ushtrojnë përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për ngritjen e SPAK-ut, për plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë, për promovimin e të gjithë gjyqtarëve e prokurorëve, për plotësimin e vendeve vakante, si dhe për mirëfunksionimin e sistemit të ri të drejtësisë.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Fjalën e ka deputetja Klotilda Bushka. Të përgatitet deputeti Taulant Balla.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Vetëm tre vjet pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese, që i hapën rrugën reformës në drejtësi, sot me kënaqësi konstatoj se po diskutojmë, shqyrtojmë dhe miratojmë akte, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e reformës në drejtësi.

Për këtë maxhoracë qeverisëse drejtësia e reformuar, si një nga elementet kyç të shtetbërjes dhe thelbi i një shoqërie demokratike, është rruga drejt shembjes së murit të lartë të pandëshkueshmërisë, heqjes së imunitetit të të paprekshmëve, të politikanëve dhe pushtetarëve që shkelin ligjin, familjarëve dhe ortakëve ekonomikë, që grumbullojnë përfitime të paligjshme.

Ashtu siç e premtoam, ky mandat qeverisë ka në qendër të vëmendjes zbatimin e plotë të reformës në drejtësi për të krijuar një shoqëri, në themel të së cilës qëndron e drejta, merita, vlera qytetare, sociale dhe profesionale e çdo individi, e një shoqërie solidare me shtresat në nevojë, e një shoqërie, që në bosht ka drejtësinë sociale.

Zbatimi i reformës në drejtësi po prodhon mekanizmat efektivë për të garantuar integritetin e zyrtarëve të lartë, për të pasur gjyqtarët më të mirë, më profesionistë dhe me integritet të lartë në mënyrë që qytetarëve t'u shërbehet drejtësi e paanshme, e pavarur dhe e pandikuar nga politika, pra që qytetarët të kenë akses në sistemin e drejtësisë.

Siç pranohet gjerësisht nga partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët po e asistojnë Shqipërinë në zbatimin e reformës në drejtësi, rivlerësimi kalimtar i të gjithë trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë po ecën me ritme të kënaqshme, duke pastruar nga radhët e prokurorisë dhe të gjyqësorit elementë të korruptuar, përmes një kontrolli efektiv të aftësive të tyre profesionale dhe integritetit moral e etik, në mënyrë që institucionet e sistemit të drejtësisë të çlirojnë potencialin e tyre në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit në shoqëri dhe veçanërisht në radhët e zyrtarëve të lartë.

Procesi i vettingut në drejtësi po zbatohet nga organe të pavarura, të shkëputura nga politika, të parashikuara në Kushtetutë dhe po monitorohet nga një mision ndërkombëtar.

Sot të gjithë konstatojmë se është ngritur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i cili ka në kompetencën e tij kryerjen e të gjitha procedurave që i paraprin plotësimit të vakancave në Gjykatën Kushtetuese dhe krijimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Janë ngritur dhe funksionojnë Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, dy organet më të rëndësishme të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, kanë filluar procedurat për krijimin e Prokurorisë Speciale dhe Gjykatës Speciale Antikorrupsion. Me këto ritme të reformës premiset janë që edhe vakancat në Gjykatën e Lartë të plotësohen së shpejti.

Pas zgjedhjeve të 25 qershorit 2017, ku shqiptarët folën qartë me votën e tyre për këtë maxhorancë qeverisëse, të cilët shprehën drejtpërdrejt besimin dhe mbështetjen e fortë për Partinë Socialiste dhe për programin e saj qeverisës, ne u siguruam qytetarëve se prioritet për ne do të ishte jetësimi i reformës në drejtësi, nëpërmjet ofrimit të të gjithë mbështetjes së nevojshme për realizimin e procesit të vettingut, si dhe procesin e ngritjes së institucioneve të reja qeverisëse e drejtuese të gjyqësorit dhe të prokurorisë, të domosdoshme për zbatimin e reformës në drejtësi.

Dhe ja ku jemi sot. Sot ne miratojmë numrin e personelit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, për t'i hapur rrugë mbështetjes buxhetore të funksionimit të veprimtarisë së tyre në miradministrimin e drejtësisë.

Sistemi i drejtësisë financohet nga buxheti i shtetit. Të dy këta këshilla janë organe të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili është një pushtet i pavarur, që do të thotë se gëzon pavarësi funksionale, organizative dhe financiare.

Në nenin 2 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” thuhet: “Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe eficiencës”. Pra të dy këta këshilla i vendosin vetë strukturat e tyre administrative.

Sot ne miratojmë numrin e përgjithshëm të personelit për secilin këshill bazuar në detyrimin që ka Kuvendi në kuadër të ligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019”.

Komisioni i Ligjeve, në konsultim me Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Administratës Publike, ka vlerësuar se nevojat për burime njerëzore, investime dhe shpenzime, që janë kërkuar nga të dy këta këshilla për përmbushjen e funksionit të tyre, përputhen me mundësitë buxhetore dhe financimin e zërave për mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë. Në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Ligjeve ka marrë në konsideratë se buxheti i vitit 2019 për sistemin e drejtësisë i plotëson nevojat jo vetëm për dy këshillat, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, por edhe për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, që pritet të ngrihet së shpejti, Byronë Kombëtare të Hetimit, Prokurorinë dhe Gjykatën Speciale Kundër Korrupsionit, të cilat janë në proces, drejt rrugës së tyre të krijimit. Për këtë arsye komisioni, në konsultim me Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Administratës Publike, arriti në konkluzionin se numri për secilin këshill do të jetë: për Këshillin e Lartë Gjyqësor 125 punonjës dhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë 65 punonjës.

Vendimet e sotme janë akte që thellojnë zbatimin e reformës në drejtësi, duke u dhënë mundësi të dy këshillave të zbatojnë me eficiencë funksionet, si dhe për të kryer me profesionalizëm dhe dinjitet punën e tyre.

Ne presim të rritet aksesin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe të rikthehet besimi i publikut në drejtësinë e pavarur, ku shërbejnë magjistratë dhe profesionistë me integritet të lartë. Për këtë dua të kujtoj një shprehje të Faik Konicës, i cili ka thënë: “Nëse emërohen gjyqtarë të ndershëm, të paanshëm dhe të zotë, kush qeveris vendin do të fitojë zemrën e njerëzve”. Për të tillë zyrtarë asnjë rrogë dhe asnjë shpenzim nuk do të ishte i kotë. Prandaj uroj që vërtet me këto fjalë të një mendjeje kaq të ndriçuar të ecim përpara në zbatimin e reformës në drejtësi.

Në këtë kuadër dua të falënderoj relatorin, kolegun tonë, zotin Bashkim Fino, Ministrinë e Financave, përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave për bashkëpunimin efikas, si dhe të gjithë kolegët e Komisionit të Ligjeve për

miratimin e këtyre akteve, duke u dhënë gjithë mbështetjen e nevojshme buxhetore dy organeve të reja të drejtësisë.

Në përfundim kam një fjalë për aktin e dorëzimit të mandateve nga ish-kolegët deputetë të opozitës. Deputetët betohen në emër të popullit dhe i shërbejnë vetëm popullit. Mandati i deputetit nuk lidhet me asnjë mandat detyrues. Mandati detyrues nënkupton që deputeti vë interesin e partisë mbi interesin e Shqipërisë dhe kjo është e ndaluar nga Kushtetuta e vendit tonë, pasi bie në kundërshtim me parimet e demokracisë, të pranuar nga vendet më të përparuara demokratike.

Në demokraci pushteti fitohet me votë nëpërmjet zgjedhjeve. Zotësia politike është që me punë dhe vepra të bindësh qytetarët të votojnë për forcën politike që përfaqëson, por jo me fjalë, as me rrëmuje, as me kaos, as me veprime arbitrare dhe as me pushtet në tavolinë, si ky i djegies së mandateve. Demokracia funksionon nëpërmjet zgjedhjeve e jo nëpërmjet dorëzimit të mandateve.

Ne si maxhorancë qeverisim në bazë të votës së popullit dhe do ta përmbushim këtë mision deri në fund, sipas besimit të shprehur nga sovrani në zgjedhje.

Unë sot do të kisha dashur të ishim të gjithë së bashku duke diskutuar dy vendime kaq shumë të rëndësishme për zbatimin e reformës në drejtësi, t'i votonim, siç miratuam ndryshimet kushtetuese në vitin 2016, që i hapën rrugë reformës në drejtësi. Por, fatkeqësisht, jo për të gjithë interesi i vendit është interesi primar.

Unë falënderoj të gjithë kolegët deputetë të maxhorancës, të cilët do të japin votën njëzëri për të dyja aktet që jemi duke shqyrtuar.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka deputeti Taulant Balla. Të përgatitet deputeti Adnor Shameti.

Taulant Balla – Nuk është e rastësishme që në ditën kur Kuvendi i Shqipërisë voton dy vendime të rëndësishme, atë të strukturës së Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Sali Berisha, Lulzim Basha, Monika Kryemadhi e të tjerë si këta, nuk janë më në Kuvendin e Shqipërisë. Ne e kemi thënë që prej ditës së parë dhe e kemi parashikuar që në korrik të vitit 2016, që sa më shumë do të afrohet

dita e ngritjes së Prokurorisë Speciale Antikorrupsion dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, ata që përmenda më lart dhe që sot janë bashkë me një grup huliganësh në hyrjen e parlamentit, nuk do të ishin në këtë sallë. Nuk është e rastësishme mungesa e tyre sot. Ne jemi sot këtu për t'i qëndruar besnikë votës së popullit shqiptar më 25 qershor 2017. Shqiptarët në shumicë na votuan në qershor të vitit 2017, sepse e dinë mirë se kujt t'ia besojnë votën, ditën shumë mirë të na e jepnin neve, sepse ne jemi të vetmit që mund ta çojnë përpara reformën në drejtësi.

Me këto dy vendime sot ne përmbyllim një fazë të rëndësishme të këtij procesi: fazën e ngritjes së institucioneve. Kush kishte dyshime për 16 shkurtin e “famshëm”, siç edhe ua thamë në seancën e fundit të tyre këtu, se gjoja 16 shkurti do të ishte referendum, patjetër, por ishte një referendum për shkatërrimin përfundimtar të Partisë Demokratike. Qytetarëve shqiptarë iu rikujtua se me Partinë Demokratike ringjallen huliganët, rikthehen situatat e 20 vjetëve më parë: kthim në kaos, në paligjshmëri, tipike vetëm për qeverisjen e Lulit dhe të Saliut.

Për 28 vjet me radhë Saliu dhe Partia Demokratike kanë qenë përgjegjës për skemat piramidale, për luftën civile të 1997 -ës, për grushtin e shtetit në vitin 1998, për shpërthimin e Gërdecit, për vrasjen e 4 të pafajshmëve më 21 janar, për shitjen e detit, për korrupsionin e pafund që pasuroi fëmijët, familjen e Saliut dhe të Lulit.

Nga ana tjetër Luli, përveçse për shitjen e detit dhe raportet mjekësore që e shpëtuan nga gjyqi për vjedhjen e Rugës së Kombit, mbahet mend edhe për gjumin e gjatë, plot 4 vjet, teksa ishte zgjedhur për të drejtuar Bashkinë e Tiranës.

Sot kolegë deputetë, Shqipëria është në drejtimin e duhur. Ne e kemi vendosur Shqipërinë në të njëjtin krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Europian. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Europian dhe të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Europian me në krye Gjermaninë, e kanë dënuar me forcë dhunën kundër institucioneve më 16 shkurt apo edhe dhunën që po ushtrohet sot, ku me bidonë të mbushur me benzinë në selinë e Partisë Demokratike qëllohen punonjësit e Policisë së Shtetit.

Me këto veprime, sikurse edhe veprimi për djegien e mandateve, Lulzim Basha krijoi një precedent të rrezikshëm, që nuk ka ndodhur në asnjë vend të botës, që çdo opozitë, e cila nuk kënaqet me rezultatin zgjedhor të kërcënojë me djegie mandatesh nëse nuk i jepet pushteti në tavolinë.

Harroje Lulzim!

Pushteti fitohet veçse me votë. Nuk është faji i shqiptarëve që ti nuk votohesh nga ata.

Për më shumë se një vit opozita refuzoi të merrte pjesë në Komisionin e Reformës Zgjedhore, i cili u bashkëkryesua në mënyrë shembullore nga maxhoranca dhe opozita për t'i marrë dhe për t'i implementuar tërësisht rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Por opozita nuk e ka hallin te Kodi, nuk e ka hallin te rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, por ka hallin e Saliut, të Lulit dhe të Monikës.

Kolegë deputetë,

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ai i Prokurorisë janë një konkludim i një procesi shumë të rëndësishëm, i cili po vijon përkrah procesit të rëndësishëm të vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët, që tashmë ka prodhuar rezultate të prekshme, përfshirë dhe largimin e shumë funksionarëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar të sistemit të drejtësisë. E gjithë kjo bëhet me mbikëqyrjen e plotë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Ndërsa këto arritje dëshmojnë qartë se Shqipëria e ka përshpejtuar dhe thelluar këtë moment të rëndësishëm reformash, si dhe ka konsoliduar progresin me përmbushjen e 5 prioritetëve tona kyçe për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian, protesta e dhunshme e 16 shkurtit apo edhe kjo e sotmja në hyrje të Kuvendit të Shqipërisë bashkë me vetasgjësimin e Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integritet në prag të prezantimit të paketës së zgjerimit nga Komisioni Europian dhe vetëm pak muaj nga mbledhja e Këshillit Europian në qershor, sigurisht e dëmtojnë, e minojnë dhe e sabotojnë perspektivën europiane të Shqipërisë.

Por, ne jemi Partia Socialiste e Shqipërisë; jemi votuar për të realizuar ëndrrën europiane të të gjithë shqiptarëve. Ne jemi mësuar me diversionin, por edhe me papërgjegjshmërinë e kësaj opozite, në veçanti të tre personave: të Sali Berishës, të Lulzim Bashës dhe të Monika Kryemadhit.

Në vitin 2017 Partia Socialiste e Shqipërisë ka marrë një mandat të qartë dhe të pastër për të qeverisur për 4 vjetët në vijim dhe Partia Socialiste e Shqipërisë do ta çojë këtë mandat deri në zgjedhjet e vitit 2021 në respekt të votës së qytetarëve. Ne do t'i fitojmë edhe zgjedhjet e qershorit të vitit 2021 për një mandat të tretë, sepse u kemi dëshmuar shqiptarëve se jemi besnikë ndaj tyre. Siç u kanë dhënë dhe u dhanë një leksion shembullor në zgjedhjet e vitit 2017, njësoj shqiptarët do t'u japin një leksion të ri në zgjedhjet lokale, ato të 30 qershorit. Kush ka dyshime se më 30 qershor nuk do të zhvillohen zgjedhje, e ka shumë gabim! Më 30 qershor shqiptarët do të zgjedhin 61 menaxherët e 61 bashkive.

Ne jemi sot këtu për t'u thënë shqiptarëve se ne jemi alternativa më e mirë, jemi modeli më i mirë qoftë i qeverisjes qendrore, qoftë i asaj vendore. Të dalin Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integritet dhe të thonë një model të vetëm të qeverisjes së tyre lokale, ndërkohë që ne kemi plot modele të suksesshme në çdo cep të Shqipërisë nga Tirana në Veri të Shqipërisë dhe nga Tirana në Jug të Shqipërisë. Ne jemi këtu sot për të plotësuar këtë mandat të rëndësishëm.

Askush nuk e kishte besuar se brenda vitit të parë të procesit të vetingut më shumë se 100 gjyqtarë dhe prokurorë do të kalonin në këtë proces. Vetëm nga janari deri në dhjetor të 2018-ës janë dhënë 42 vendime për konfirmimin në detyrë, 18 prokurorë, 4 ndihmësligjorë dhe 20 gjyqtarë. Ndërkohë që janë dhënë 35 vendime për shkarkimin nga detyra të 22 gjyqtarëve, 12 prokurorëve dhe një ndihmësligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, 7 vendime për ndërprerjen e procesit për 4 gjyqtarë, 2 prokurorë dhe një ish- këshilltar, 8 vendime për pushimin e procesit për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmës. Procesi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit vijon të ushtrohet me përpikëri nën monitorimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Kolegë dhe kolegë deputetë,

Sot është dita për t'u konfirmuar shqiptarëve atë që ne kemi thënë me bindje 2 vjet më parë, se kur do të afrohet dita e ngritjes së Prokurorisë Speciale Antikorrupsion dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, Saliu nuk do të jetë më këtu.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka zoti Ervin Bushati. Të përgatitet deputetja Ermonela Felaj.

Ervin Bushati – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Sot miratojmë pavarësinë buxhetore të drejtësisë së re shqiptare. Në fakt, pavarësia ekonomike do të bëjë të mundur lindjen e një drejtësie të re për qytetarët shqiptarë që e meritojnë këtë ditë, sepse kanë pritur kaq gjatë me besim të plotë se drejtësia do të vijë më në fund. Nëse sot ne shikojmë se kjo drejtësi po lind me disa dhimbje, dhimbjet janë jashtë kësaj salle, ndërsa këtu ne miratojmë një drejtësi të pavarur për qytetarët shqiptarë. Ata që shkaktojnë sot dhimbje, kanë shkaktuar gjithmonë dhimbje sa herë ka ardhur momenti për të dhënë atë që duhet për qytetarët: drejtësinë, zhvillimin dhe një jetë më të mirë për familjet e Shqipërisë. Ajo që e bën sot bashkë PD-në dhe LSI-në nuk është asnjë bazë ideologjike apo një ndarje programatike, sepse nëse nga një krah kemi një të majtë ekstreme si LSI-ja dhe nga krah tjetër kemi një të djathtë, ajo që i bën bashkë është gjithmonë pazari, ajo që i bën bashkë është frika nga drejtësia, kjo drejtësi e re, e cila do t'i vërë para përgjegjësisë ata që kanë bërë zullume, të cilët nuk kanë sot asnjë bazë programatike, asnjë kundërshtim me maxhorancën, por kanë frikë nga drejtësia.

Sot ne miratojmë 400 milionë në ndihmë të strukturave të reja të KLP-së dhe të KLGJ-së, të parashikuara në buxhetin e shtetit, që është miratuar që në dhjetor të vitit të kaluar. Opozita jo vetëm që e ka bojkotuar këtë sallë që nga shtatori, por e ka humbur trenin për të qenë pjesë e reformave, për të votuar për qytetarët shqiptarë në shumë çështje të rëndësishme, për buxhetin e vitit 2019, që parashikonte këto ndryshime për drejtësinë, për lojërat e fatit dhe për çështje shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me bujqësinë, me drejtësinë, me shëndetësinë dhe me arsimin në Shqipëri. Erdhën vetëm kur mendonin se mund t'ju digjeshin mandatet në fund të dhjetorit, ndërkohë që shkuan dhe në një akt të pashembullt dhe të pashoq: dorëzuan mandatet. U dorëzuan, bashkë me mandatet edhe PD-ja, edhe LSI-ja pikërisht

sot që do të vendoset për t'i hapur rrugë drejtësisë së vërtetë në Shqipëri. Gjithçka që kanë bërë PD-ja dhe LSI-ja, me një akt kolektiv bolshevik që nuk ka lidhje me demokracinë dhe nuk ka precedentë në asnjë vend të qytetëruar të botës, nuk është parë në asnjë demokraci dorëzimi në masë i mandateve, dorëzimi në masë i punës, për të cilën janë votuar, tregon dëshpërimin e vërtetë. Ky është akt i një dëshpërimi politik, i cili vjen nga frika që kanë nga proceset e drejtësisë që sapo marrin jetë këto ditë.

Në strukturat e reja të KLGJ-së dhe të KLP-së, duke u shtuar përkatësisht me 125 anëtarë për KLGJ-në dhe 65 për KLP-në ne mundësojmë pavarësinë e vërtetë funksionale dhe ekonomike të këtyre dy trupave, që të mos jenë të varura më nga shteti, nga qeverisja apo nga maxhoranca. Për herë të parë kjo pavarësi ekonomike do të bëjë të mundur që ata të fillojnë të operojnë dhe të jenë në funksionim të plotë për të dhënë drejtësi për qytetarët shqiptarë.

Të gjitha argumentet që ka sjellë këto ditë opozita nuk qëndrojnë, sepse nuk janë thënë për herë të parë dhe nuk janë dëgjuar në sallën e parlamentit, nuk janë dëgjuar para parlamentit. Sot i shikojmë që përpiqen të flasin atje me mikrofon, ndërkohë që kanë pasur në dispozicion një vit kohë për të ardhur në parlament dhe nuk kanë ardhur.

Ai që është i zoti i bën të gjitha. Opozita duhet të ishte edhe sot në seancë, mund të shkonte edhe nesër në protesta, mund të vazhdonte të funksiononte si të donte në çdo qytet, brenda dhe jashtë sallës, në komisione, në parlament, në qytete dhe në të gjithë Shqipërinë, por ata e kanë braktisur detyrën kryesore, ndërkohë që sot qahen për paratë që i jepen drejtësisë, për këta 400 milionë, kur kanë më shumë se 2 vjet që marrin rrogat nga buxheti i Shqipërisë, i cili nuk paguhet nga Partia Socialiste, nuk paguhet nga maxhoranca, por mbledhet nga taksat e qytetarëve shqiptarë. Deputetët e PD-së dhe të LSI-së e kanë marrë rrogën kot.

Ndërkohë që sot për herë të parë po miratohet funksionimi i drejtësisë së pavarur, nuk janë këtu në këtë sallë, të paktën të mbështesin reformën në drejtësi. Këta 400 milionë, që po shpenzohen sot, në fakt janë investim i vërtetë për drejtësinë. Në opinionin

tim si ekonomist ky nuk është shpenzim, por është një investim për drejtësinë, është një investim për të ardhmen. Janë 400 milionë lekë të shpenzuara më mirë në ndërtimin e shtetit shqiptar, 400 milionë lekë që shkojnë për drejtësinë e qytetarëve shqiptarë. Të gjithë partnerët ndërkombëtarë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE-ja, FMN-ja, Banka Botërore dhe çdo institucion që e vlerëson Shqipërinë, se reforma në drejtësi është kryereforma që ka kryer shteti shqiptar, kanë thënë se reforma në drejtësi nuk duhet të ndalet për asnjë arsye dhe duhet të vazhdojë përpara me çdo kusht. Reforma në drejtësi është e vetmja që garanton se më në fund proceset e drejtësisë do të jenë të pavarura nga politika. Prandaj është e çuditshme që në një ditë kaq të rëndësishme, në disa seanca po kaq të rëndësishme, që kanë pasur të bëjnë me reformën në drejtësi, me buxhetin, me çështje të rëndësishme për qytetarët shqiptarë, opozita nuk ka marrë pjesë në asnjë nga seancat dhe në asnjë nga komisionet. Më vjen keq që nuk janë diskutuar në Kuvendin e Shqipërisë, nuk kanë pasur mundësi ndoshta, pse jo, edhe të përmirësohen shumë ligje, shumë iniciativa, shumë reforma, duke pasur edhe bashkëpunimin, pse jo, edhe të opozitës. Opozita në definicion është për të kundërshtuar. Duke qenë në minorancë, detyra e opozitës ndaj qytetarëve shqiptarë ka qenë të na bënte oponencë, të kundërshtonte ligjet tona dhe nëpërmjet diskutimit ne të arrinin dhe të kishim ligje më të mira për shqiptarët. Por opozita nuk e ka pranuar për asnjë moment verdiktin e shqiptarëve, sepse nuk përkujdeset për qytetarët e vet, do vetëm të ketë karrigen e Kryeministrit, një karrige që nuk mund ta marrë dot me vota, sepse e di shumë mirë, ashtu si para një viti e gjysmë, prandaj përpiqet ta marrë nën tavolinë ose në tavolinë atë që nuk e merr dot në kutinë e votimit.

Në qoftë se opozita do të ishte kaq e shqetësuar dhe do të kishte dyshime, ta kishte deklaruar qysh në shtator të vitit 2017. Opozita i njohu zgjedhjet, hyri në parlament, për herë të parë nuk ka pasur asnjë diskutim për rezultatin në një proces që ka qenë tërësisht i balancuar. Zëvendëskryeministri ka qenë i opozitës, ministri i Brendshëm ka qenë i opozitës, kryetari i KQZ-së ka qenë i opozitës, shumica e të gjithë ministrave, që kishin lidhje me zgjedhjet, prapë ishin të opozitës dhe, pasi mbaruan zgjedhjet,

opozita nuk pati asnjë objeksion. Nuk kemi asnjë çështje të çuar për ndjekje penale, ndërkohë që kishin një zëvendëskryeministër, një ministër Drejtësie, që sot del dhe kundërshton, kishin edhe një kryetar të KQZ-së, që nuk e kundërshtoi për asnjë moment procesin zgjedhor. Po pse ndodhi kjo pikërisht tani?

Ajo që i bën bashkë LSI-në dhe PD-në nuk është bashkëpunimi, por është frika nga humbja, është frika nga drejtësia. Ata janë bërë bashkë jo se janë kundër maxhorancës dhe kundër Edi Ramës, por se janë kundër zgjedhjeve, se e dinë që humbasin në zgjedhjet e qershorit dhe janë kundër drejtësisë, që nuk mund të shmanget më. Ajo që po themi ne, atë që po thotë maxhoranca, që po thotë PS-ja, ka gjetur jehonë, është përsëritur nga SHBA-ja, nga BE-ja, nga Gjermania, nga të gjithë partnerët tanë, që na kanë mbështetur dhe do të vazhdojnë të na mbështesin jo vetëm me mbështetje politike dhe me fjalë, por me programe, me para të taksapaguesve të tyre, të cilat i kanë investuar në Shqipëri.

Ashtu si në reformën në drejtësi, ashtu si në Kodin Zgjedhor, e njëjta gjë ka ndodhur si me SHBA-në, si me BE-në dhe me Gjermaninë, e cila me lekët e taksapaguesve gjermanë ka financuar për reformën zgjedhore dhe për një kod zgjedhor në Shqipëri, që kjo opozitë ka papërgjegjshmërinë të mos e miratojë këtu bashkë me ne.

Ndaj kolegë, ju ftoj ta votojmë këtë projektligj, të votojmë edhe të gjitha ligjet e tjera, se, pavarësisht presionit absurd që bën opozita jashtë dverve të kësaj sale, ne jemi këtu me mandatin e qytetarëve, jemi këtu për të vazhduar reformat dhe për ta çuar Shqipërinë drejt Europës.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjalën e ka deputetja Ermonela Felaj!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja drejtuese!

Në fakt, ne jemi këtu si pasojë e një detyrimi që kemi, një detyrimi shumë madhor dhe një privilegj që na kanë dhënë qytetarët.

Ne jemi zgjedhur deputetë, dhe pikërisht për faktin se jemi zgjedhur deputetë, kemi detyrimin të jemi në këtë sallë, kemi detyrimin që për asgjë dhe për asnjë moment të mos

humbasim fokusin e punës sonë si deputetë, si përfaqësues të zgjedhur të popullit.

Natyrisht, ne nuk mund t'i shpëtojmë përjetimit të të gjithë qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi. Në fund të ditës edhe ne jemi qytetarë, edhe ne jemi familjarë, edhe ne jemi shqiptarë dhe sigurisht që çdonjëra prej pamjeve që është duke u transmetuar, çdonjëra prej pamjeve që ndodhi më 16 shkurt, apo çdonjëra prej pamjeve që u shfaq të enjten e kaluar e turpëron Shqipërinë. Nuk ka pasur asnjë frikë dhe nuk ka asnjë arsye që ne të ndryshojmë oraret e mbledhjes së Kuvendit të Shqipërisë.

Kuvendi i Shqipërisë do të mbledhet rregullisht, sepse ka detyrën e tij, por Kuvendi i Shqipërisë nuk është gjahu i huliganëve, nuk është gjahu i rrugaçëve që PD-ja dhe LSI-ja kanë lëshuar në rrugë.

Ne sot jemi mbledhur për t'i dhënë mundësi arkitekturës së sistemit në drejtësi që e gjithë ngrehina të mund të funksionojë. Jemi në metrat e fundit. Dy organe të rëndësishme të qeverisjes së gjyqësorit, KLGJ-ja dhe KLP-ja janë konstituar. Tanimë ata kanë filluar punë, pritjet plotësimi me strukturë të tyre dhe ky është vendimi që ne do të miratojmë sot, duke bërë të mundur që të dyja këto organe të rëndësishme, që dispijonojnë dy degë të drejtësisë, gjyqësorin dhe prokurorinë, të mund të vihen atje ku duhen, të vihen në shinat e punës dhe të mund të veprojnë me të gjithë forcën e ligjit kundër çdo kundërvajtësi të ligjit.

E kishim bërë këtë premtim dy vjet më parë. Nuk ka qenë aspak një reformë e lehtë. Mund të themi me plotë gojën se ka qenë një nga reformat më të vështira që ka ndërmarrë Kuvendi i Shqipërisë dhe kjo maxhorancë. Vështirësitë e zbatimit të kësaj reforme nuk kanë ardhur thjesht nga fakti se është një reformë që përmbys tërësisht një sistem, të cilin ne e kemi njohur dhe zbatuar më parë, por vështirësitë kanë qenë të qëllimshme, kanë qenë të sajura nga këta njerëz. Pra, jo rastësisht, përkimi i fillimit të protestave nga ana e opozitës, jo rastësisht shkuarja deri në zgjidhjen e fundit, atë të djegies së mandateve, përkohë me këto momente kulminante të zhvillimit të reformës në drejtësi, që kanë të bëjnë me funksionimin normal të dy qeverive, të gjyqësorit dhe të prokurorisë, dhe, natyrisht, kanë të bëjnë edhe me vënien në funksion të prokurorisë kundër krimit të organizuar, të

njohura si SPAK-u dhe Gjykata e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

Natyrisht, ne kemi bërë çmos që e gjitha të mos pengohet asnjë ditë, pavarësisht se të gjithë qytetarët shqiptarë janë dëshmitarë se cilët kanë qenë të interesuarit në vetë të parë që kjo reformë të mos bëhej. Qytetarët shqiptarë kanë qenë dëshmitarë të faktit që në vitin 2009, ne do të ishim këtu në këtë sallë, do të ishim maxhoranca e kësaj salle dhe ato zgjedhje nuk ishin as të lira, as të ndershme dhe e dimë shumë mirë se çfarë u bë në të gjithë Shqipërinë, ne e dimë shumë mirë se çfarë ka bërë çdonjëri nga njerëzit e opozitës, të cilët dalin sot dhe përpiqen të eksitojnë një turmë të pakënaqur njerëzish, përpiqen t'i përdorin për interesat e tyre të ardhjes në pushtet. Për çdonjërin nga ata ka një çështje, për çdonjërin nga ata ka një dëm. Ka ardhur koha që ne të tregohemi të guximshëm deri në fund dhe të mos kemi asnjë lloj tolerance, në mënyrë që secilit nga këta njerëz që ka thyer ligjin, secilit nga këta që mban koston e lënies së vendit mbrapa, ndërkohë që janë bërë reforma të njëpasnjëshme për të siguruar që Shqipëria të jetë një vend i denjë, njësoj si vendet e tjera të BE-së, t'i tregohet vendi.

Unë mendoj se çdonjëri koleg, çdonjëri qytetar, që është duke na ndjekur, na mbështet me zemër të hapur. Më besoni, jo juve, u them të gjithë qytetarëve, sepse ne jemi kolegë dhe ndajmë të njëjtat përgjegjësi dhe ndjesi, ajo që kemi konstatuar këto ditë është se PS-ja gëzon një mbështetje më të madhe se ajo që gëzonte në vitin 2013, PS-ja gëzon një mbështetje më të madhe se ajo që gëzonte në vitin 2015, PS-ja sot është më e votuar se ç'është votuar në vitin 2017 dhe të gjitha këto vota janë vota të lira, janë vota zemre, janë vota shqiptarësh.

Socialistët nuk kanë nevojë të blejnë asnjë votë, sepse e kanë pasur gjithmonë fitoren te njerëzit dhe te fakti që dinë të ndërveprojnë dhe të rrinë pranë njerëzve të thjeshtë të këtij vendi. Le ta shfrytëzojmë të gjithë këtë energji njerëzore në favor të njerëzve, për t'i siguruar dhe për t'u dhënë shpresë se ky vend nuk kthehet pas, ky vend nuk kthehet dot në vitin '97, ky vend nuk kthehet dot në vitin '98, ky vend nuk kthehet dot as në vitin e errët 2011, as në vite të tjera të qeverisjes së PD-së. Kjo s'ka për të ndodhur kurrë, sepse çdo gjë ka ndryshuar, njerëzit janë më të vetëdijshëm, njerëzit nuk janë

më militantë të verbër të partive politike. Ata dinë ta bëjnë diferencën dhe, natyrisht, populli shqiptar nuk është aliazhi që kërkon të paraqesë Lulzim Basha, Sali Berisha e të tjerë, aliazhi mes pulës qorre dhe prepotentit. Këto fjalë thoshte një nga ish-koleget tona deputete të kësaj partie dhe me të drejtë unë dua t'i përgjigjem nga kjo foltore se populli shqiptar është ai që di të vlerësojë të mirën, populli shqiptar është ai që di të vlerësojë të drejtën dhe ai që di t'i tregojë vendin çdo kusari.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Ministre!

Elisa Spiropali – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Sot parlamenti nuk është i cunguar, por i çliruar, i çliruar nga kasta që ka marrë peng PD-në, i çliruar nga llumi që ka marrë peng demokratët e ndershëm dhe kërkon të marrë peng Shqipërinë, nga llumi i urrejtjes, i vulgaritetit, i injorancës, shpifjes dhe dhunës.

Opozita ose ish-qeveria është ende në trupin e Shqipërisë, aty ku dhemb më shumë, e papenduar për plagët që ka hapur, për çoroditjen kombëtare, për varfërinë kombëtare, për krimin, për korrupsionin e legalizuar, për shpifjen e shenjtëruar, për nxirjen e mediatizuar. Kjo nuk është një dramë, as një tragjedi, por një teatër i madh dëshpërimi nga pafuqia për të fituar zgjedhjet e radhës dhe frikë nga pjella e reformës në drejtësi, prokuroria speciale antikorrupsion, e cila tashmë ka dalë nga makthet e tyre dhe po bëhet realitet.

Sot ne votojmë strukturat e KLP-së dhe KLGJ-së. Opozitarët nuk janë këtu, sepse këtu nuk kanë qenë asnjë moment për të votuar reformën në drejtësi, për ta mbështetur dhe për ta çuar përpara dhe, sigurisht, kuptueshëm, sot nuk janë këtu si dëshmi e qartë se arratinë e kanë marrë pikërisht prej kësaj arsyeje.

Lidershipi opozitar ka dalë përfundimisht nga kontrolli dhe jashtë parlamentit pa kthim. Ka nxjerrë kolegët opozitarë, të cilët jo të gjithë e firmosën me vullnet atë copë letër, kur hiqnin dorë nga detyra e përfaqësimit. U detyruan nga rrëmeti që lidshipi i partisë mblodhi në oborrin e SHQUP-it si presion, gjoja popullor, mbi deputetët opozitarë.

Pasi nuk la gjë pa bërë për të justifikuar humbjen e zgjedhjeve të shkuara, Lulzim Basha s'kishte më asnjë mundësi të justifikonte humbjen e zgjedhjeve të ardhshme. Kjo mjaftoi që plaku vizëhequr që jep shpirt, por nga zakoni i zjarrvënësit dorë nuk heq dhe s'ka për të hequr kurrë, u bë baruti dhe shkrepësja që dogji partinë që solli parlamentarizmin në Shqipëri.

Kjo tragjikomedi vihet në skenë në emër të popullit, por inskenohet nga *the usual suspects*, të dyshuarit e zakonshëm, ata që në qeverisje popullit i kanë punuar qindin dhe në opozitë e kanë mbytur me helm për kundërshtarët, duke u bërë eko ulërimave të të njëjtit njeri; mafiozë, kriminelë, drogaxhinj, hajdutë, me fis, me farë, me të vdekur, me të gjallë, ditën, natën, pa asnjë kujdes për mjedisin politik dhe shoqëror, pa asnjë gajle për interesin kombëtar, duke e nxirë me moton "pas meje qameti".

Sigurisht, nuk është një e mirë për parlamentarizmin ikja, arratia e tyre nga detyra e deputetit, por fundi i botës nuk është, nuk është kurrësi, madje besojmë se mund të jetë mundësia e madhe e pastrimit të politikës nga elita e degraduar e një partie, e cila nuk mundi të reformohet, por vendosë të djegë veten në sy të shqiptarëve.

Sigurisht, ata nuk mund ta marrin peng Shqipërinë, i bëjnë dëm patjetër, u bëjnë dëm atyre që duan të shtohet numri i turistëve në këtë vend, i bëjnë dëm biznesit, u bëjnë dëm shqiptarëve që duan që Shqipëria të jetë një vend europian si gjithë të tjerët, atyre që janë lodhur me klithmat e të njëjtëve njerëzve, që janë lodhur me Shqipërinë, që duan ta mbajnë në *statusquo* konstante, por, ata nuk mund të marrin peng një vend të tërë. Asnjë lëshim ndaj tyre! Çdo mirëkuptim për qytetarët demokratë dhe qytetarët që u kanë besuar! Kjo qeveri është edhe e atyre. Që tani e tutje njerëzit, që kanë mbetur të papërfaqësuar nga PD-ja, nga lidshipi i saj, do të jenë të përfaqësuar nga ne në këtë Kuvend. Qeveria që është këtu, është qeveria e tyre. Ne nuk do të pajtohemi kurrë me aktet fashistoide të dy forcave politike, të cilat së bashku kanë vrarë dhe janë të gatshëm të vrasin sërish, madje t'i vënë flakën Shqipërisë për të ruajtur mall e gjë. Sot kanë dalë në ilegalitet; kanë humbur mandatet; kanë hequr dorë nga përfaqësimi dhe mendojnë se janë luftëtarë të lirisë, të cilët në qytet, në mal, në kodër do të luftojnë me armiqet

e vendit, që janë këtu në qeveri. Meqë mendojnë se luftëtarët e lirisë janë si ata, dua t'u kujtoj një shprehje të Çerçiz Topullit: "Kush lufton për plaçkë, plaçkë është edhe vetë". Ta kenë të qartë se nuk ka shqiptarë që nuk e di se ata luftojnë për plaçkë! Ata luftojnë për pushtet; ata luftojnë për gjënë që kanë vjedhur. Ta kenë të qartë se asnjë lëshim nuk do t'u bëjnë shqiptarët atyre dhe në zgjedhjet e qershorit dhe në të ato të vitit 2021 do t'i degdisin aty ku e kanë vendin, në koshin e historisë dhe nga ajo mund të lindë një opozitë e re dhe e vërtetë shqiptare dhe për shqiptarët.

Faleminderit shumë!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka ministrja Olta Xhaçka.

Të përgatitet deputetja Blerina Gjylameti.

Olta Xhaçka – Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë shqiptarë që na ndiqni nëpërmjet ekranit,

Shumë prej jush gjatë këtyre ditëve më kanë pyetur me shumë habi se çfarë po ndodh me opozitën. Në fillim nuk kam pasur përgjigje, sepse më është dukur po aq absurde, sa edhe juve, por sot kam përshtypjen se i kam idetë pak më të qarta. Ajo që po ndodh me opozitën është një absurditet i jashtëzakonshëm, i cili e ka çuar në një pikë pa kthim mbrapa: në pikën që ka braktisur këtë arenë, ku debatohen alternativat, ku votohen ligjet dhe reformat që u duhen të gjithë shqiptarëve.

Jo më larg se dje isha në një vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut. Kolegët atje me treguan se sa e ngjashme është përpjekja dhe skenari i opozitës sot me skenarin e maxhorancës se dikurshme atje. Pavarësisht se nga pozicione të ndryshme, ata atëherë në pushtet, këta këtu në opozitë, racionalja është e njëjtë: këta njerëz kanë frikë, sepse sot po bëhet funksionale reforma në drejtësi.

Më gjithë respektin që kam për mbështetësit e opozitës, për opozitarët e vërtetë, këtu nuk bëhet fjalë për grupe përfaqësuese, nuk bëhet fjalë për sindikata, për studentë, për profesionistë, për qytetarë opozitarë. Për fat të keq, nuk bëhet fjalë për frikën e tyre, sepse ata e kanë sot dhe do ta kenë gjithmonë të drejtën e tyre kushtetuese për të protestuar për një alternativë më të mirë, e cila mund të mos jetë kjo qeveri, por bëhet fjalë për frikën e drejtuesve të opozitës, një grusht njerëzish që u tremben

mëkateve të tyre kur ishin në pushtet, që i tremben drejtësisë.

Janë të njëjtët njerëz, një pjesë e të cilëve u bënë pjesë e qeverisë për katër vjet dhe një pjesë tjetër që bashkëqeverisën me këtë qeveri përpara zgjedhjeve, që pretendojnë se nuk janë legjitime; që drejtuan ministritë më të rëndësishme, agjencitë dhe drejtoritë më të rëndësishme, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; që prodhuan raporte para dhe paszgjedhore dhe në fund i njohën zgjedhjet. Ndaj them me keqardhje se kjo që po bën sot opozita, është një tentativë tejet e ulët ndaj të gjithë atyre që pretendon se përfaqëson, një tentativë tejet e ulët ndaj të gjithë shqiptarëve. Për hatër të frikës së mëkateve që kanë bërë kur ishin vetë në pushtet, janë gati të shkatërrojnë ekonominë, të pengojnë aspiratën e madhe të shqiptarëve për integrim, të mbajnë peng të ardhmen europiane të fëmijëve tanë, të fëmijëve të të gjithë shqiptarëve.

Sot, si asnjëherë më parë, fatmirësisht ka një konsensus të madh të të gjithë aktorëve dhe faktorëve progresistë që e duan Shqipërinë, për të vazhduar rrugën tonë drejt Europës. Jam e bindur se, duke mos dashur të dorëzohemi para këtyre shantazheve banditeske, respektojmë jo vetëm këshillat dhe mbështetjen e partnerëve tanë strategjikë dhe atyre europianë, por përfaqësojmë 90% të shqiptarëve që duan drejtësi, siguri dhe integrim. Bashkë me aleatët tanë do ta çojmë deri në fund këtë premtim.

Siç na tregoi skenari maqedonas, përpjekjet për dhunë dhe destabilitet nuk kalojnë pa u ndëshkuar. Siç theksova edhe dje me homologen maqedonase, kalvari i vështirë që përjetoi Maqedonia e Veriut gjatë viteve të fundit na tregoi se shpesh kërcënimet më të mëdha, me të cilat duhet të përballemi në punën tonë, nuk janë ato që vijnë nga jashtë, por ato që vijnë nga brenda, sepse, fatkeqësisht, siç ndodhi në Maqedoninë e Veriut dhe, siç po ndodh sot në Shqipëri, në vendet tona ka jo rrallë forca që për interesat e tyre të ngushta, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me interesat e përbashkëta të të gjithë qytetarëve shqiptarë apo të vendeve tona, janë gati të rrezikojnë edhe stabilitetin, edhe zhvillimin, edhe të ardhmen tonë europiane. Nga ana tjetër, kam besim të plotë se, për aq kohë sa shumica e qytetarëve të vendeve tona besojnë tek ideali euroatlantik dhe te dëshirat e ëndrrat që përmenda më lart, rruga jonë drejt Europës, një

rrugë që kalon nëpërmjet modernizimit të vendeve tona, mbi të gjitha, nëpërmjet vendosjes së sundimit të ligjit dhe të drejtësisë, është e pandalshme dhe këto forca janë të destinuara të dështojnë. Ashtu siç ndodhi në Maqedoninë e Veriut, ashtu do të ndodhë edhe në Shqipëri dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Xhaçka!

Fjalën e ka deputetja Blerina Gjylameti.

Të përgatitet ministri Eduard Shalsi.

Blerina Gjylameti – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot jemi mbledhur për të miratuar strukturat e dy organeve shumë të rëndësishme të drejtësisë, të cilat synojnë që në këtë erë që ka nisur Shqipëria, të rikthejmë edhe një herë besimin e humbur të shqiptarëve për tri dekada. Pavarësisht zërave skeptikë në muajt e parë, tashmë të gjithë janë të bindur se kjo reformë është një proces i pandalshëm dhe ka hyrë në rrugën pa kthim të rivendosjes së drejtësisë. Treguesi më i mirë i saj është edhe frika që ka kapluar opozitën, e cila ka braktisur karrigen e saj në aureolën e demokracisë, sikurse është në çdo vend, duke dalë në rrugë për të djegur dhe për të shkatërruar. Kushdo që thotë se protesta e opozitës nuk ka kuptim, gabohet rëndë. Në fakt, ajo ka shumë kuptim. Ata protestojnë nga frika që kanë nga drejtësia, e cila po rivendoset tashmë. Në tri dekada ishin mësuar që të gjithë korrupsionin galopant dhe krimet ndaj shqiptarëve t'i mbyllnin me gjyqtarë me arsim 6-mujor të “Shkollës së Plepave”, të cilët meritë të vetme kishin bindjen ndaj doktorit apo parim të vetëm kishin paratë.

Ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka mundësuar edhe vijimin e procedurave për ngritjen e Prokurorisë Speciale, për korrupsionin e zyrtarëve të lartë, dhe Byrosë së Hetimit. Kjo e tremb opozitën, të nderuar kolegë.

Të nderuar qytetarë, sa më shumë afrohet dita e konsolidimit të drejtësisë së re, sa më shumë afrohet dita për ngritjen e SPAK-ut dhe BKH-së, ne do të kemi këtë sjellje joligjore të opozitës.

Kam bindjen e plotë, të nderuar qytetarë, dhe ju drejtohem pikërisht juve, që nuk besoni te Lulzim Basha, se nuk mund të ketë arsye besimi

për t'i dhënë kapital Bashës me shenjat e gjakut në duart e tij prej “21 Janarit”, me xhepat e shqyer nga milionat e eurove të vjedhura në Rrugën e Kombit apo në Bashkinë e Tiranës në gjumin katërvjeçar si kryebashkiak. Shqiptarët e bëjnë tashmë dallimin. Ata janë alternativa e dhunimit të institucioneve, ithtarët e prishjes së pronës publike, planprishësit e integritetit të Shqipërisë dhe armiq të përbetuar të drejtësisë.

Për sa u përket këtyre dy ligjeve, që ne duam të miratojmë sot, mjafton të lexojmë disa statistika. Më shumë se 50% e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk kanë arritur ta kalojnë provimin e vetingut, midis të cilëve edhe persona që konsideroheshin të paprekshëm dhe ishin kthyer në bejlerë të drejtësisë. Vetëm gjatë vitit 2018, nga 92 gjyqtarë, prokurorë, ndihmësligjorë, që kanë kaluar në sitën e vetingut, 50 prej tyre ose janë shkarkuar nga komisionet e vetingut, ose janë tërhequr më parë për të mos u diskredituar gjatë kontrollit.

Deri në datën 24 dhjetor të vitit 2018 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë në total 92 vendime, ku 42 vendime janë për konfirmimin në detyrë të 20 gjyqtarëve, 18 prokurorëve, 4 ndihmësveligjorë; 35 vendime janë për shkarkim nga detyra, ndërmjet të cilëve 22 gjyqtarë, 12 prokurorë, 1 ndihmësligjor; 7 vendime janë për ndërprerje të proceseve për 4 gjyqtarë, 2 prokurorë, 1 këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese dhe 8 vendime pushimi për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmësligjorë në Gjykatën e Lartë. Pra, sikurse tregojnë edhe këto shifra, shikohet qartë që bëhet fjalë për më shumë se gjysmën e njerëzve të drejtësisë, të cilët kanë mbetur në klasë, për rrjedhojë janë larguar nga sistemi i drejtësisë. Kush pretendonte se organet e reja do të plotësoheshin me të paaftë, e ka gabim përsëri. Mjafton të shikojmë të dhënat dhe rezulton fare qartë se rregullat janë strikte, duke u hapur rrugë vetëm atyre, të cilët vërtet e meritojnë të japin drejtësi në emër të ligjit. Nga 13 kandidatët për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, 7 prej tyre janë shkarkuar, 4 janë konfirmuar në detyrë, njërit i është ndërprerë procesi i rivlerësimit dhe një tjetër është në proces rivlerësimi. Nga 17 kandidatë për KLGJ, 6 prej tyre janë shkarkuar nga detyra, njërit i është ndërprerë procesi i vlerësimit dhe 10 prej tyre janë konfirmuar në detyrë. Po ashtu, nga 19 kandidatë për Këshillin

e Lartë të Prokurorisë, 9 janë shkarkuar, 10 janë konfirmuar në detyrë. Mjafton të shikojmë këto shifra për të kuptuar ekzaktësisht seriozitetin dhe rregullat strikte të funksionimit të drejtësisë.

Të nderuar kolegë,

Ajo që po ndodh sot këtu, brenda sallës, dhe ajo që po ndodh jashtë kësaj sallë tregon për një dallim të qartë ndërmjet nesh, që kemi marrë besimin për të qeverisur me një mandat të plotë, me një maxhorancë të konsoliduar drejt rrugës së integritetit europian dhe atyre, që kanë si alternativë të vetme përkundrejt frikës, e cila i ka kapluar nga vendosja e drejtësisë, atë që shikoni: dhunën, djegien, kaosin për të penguar atë që është rruga e integritetit të Shqipërisë, për të penguar atë që është ëndrra e çdo shqiptari jo vetëm rivendosja e drejtësisë, por edhe ajo, që është ëndrra jonë: të ndërtojmë një Shqipëri brenda Europës.

Të nderuar kolegë dhe të nderuar qytetarë shqiptarë,

Në vitin 2017 votuat dhe besuat në programin e Partisë Socialiste pas një marrëveshjeje politike, ku gjysma e qeverisë ishin përfaqësues të Partisë Demokratike. Ministri i Drejtësisë, ministri i Brendshëm, ministri i Arsimit, ministri i Shëndetësisë, zëvendëskryeministri, kryetari i KQZ-së, pra të gjithë ishin përfaqësues të PD-së. Ata që ishin në krye të institucioneve përgjegjëse për monitorimin dhe menaxhimin e procesit zgjedhor, ishin të propozuar nga Partia Demokratike. Qytetarët shqiptarë votuan Partinë Socialiste dhe programin e saj. I dhanë 74 mandate, që ishin 74 arsye e përgjegjësi më shumë për ta çuar Shqipërinë përpara në rrugëtimin e reformave, të cilat ishin shumë të rëndësishme në 4-vjeçarin e parë, shpeshherë edhe me dhimbje, shpeshherë jo në nivelin e asaj që ishte pritshmëria e çdo shqiptari, por në rrugën e duhur të Shqipërisë drejt integritetit europian, në rrugën e stabilitetit ekonomik-financiar, por edhe stabilitetit politik, në një rrugë, e cila, sikurse ka treguar gjithmonë Partia Socialiste, është rruga e duhur dhe alternativa e duhur.

Kur përfunduan zgjedhjet, të gjithë e njohëm rezultatin e zgjedhjeve. Nuk kishte kontestime. Partia Demokratike e njohu rezultatin. Atëherë, të nderuar kolegë, për çfarë protestohet sot? Protestohet për një rezultat të

njohur ndër vite, për ata që ishin pikërisht përfaqësuesit e tyre në krye të institucioneve që menaxhuan procesin zgjedhor? Jo, të nderuar qytetarë, sot protestojnë për frikën e tyre. Sot kolegët e mi të opozitës, që e kanë lënë këtë sallë bosh, nuk kanë dalë mbi interesat e kryetarëve *de facto* dhe *de jure*, nuk kanë dalë dot përtej frikës së kapluar të Lulit, Saliut, të Monikës. Sot po përdoren pikërisht për t'i dalë kundër një kontrate, që e kanë lidhur me qytetarët shqiptarë, me ata të cilët vlerësuan dhe besuan në programin e tyre.

Të nderuar kolegë, ndër vite, sa herë që Partia Socialiste ka ardhur në pushtet, ka treguar gjithmonë që është radhitur në anën e duhur të historisë. Ne kemi treguar që nuk jemi alternativa e dhunës dhe e kaosit, por jemi alternativa e përsheptimit të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE; ne kemi treguar, me të gjithë vullnetin tonë, në çfarëdo pozicioni qofshim, qoftë nga anëtari më i thjeshtë, te deputeti, tek anëtarët e qeverisë dhe deri te kryetari i Partisë Socialiste se jemi vendosur në anën e duhur të historisë.

Kjo që po ndodh sot është shumë e turpshme. Unë u kërkoj të gjithë qytetarëve që janë jashtë, por edhe të gjithë kolegëve të mi të opozitës të dalin mbi interesat partiake, sepse, mbi të gjitha, ata duhet të jenë përfaqësues, së pari, të interesave të fëmijëve të tyre, së dyti, të fëmijëve tanë dhe, së treti, të të gjithë shqiptarëve. Ne sot nuk mund të dalim kundër, por duhet të jemi pro interesit të qytetarëve shqiptarë që na kanë votuar, por edhe atyre që nuk kanë votuar, të cilët shpresojnë dhe ëndërrojnë një Shqipëri komplet ndryshe nga ajo që duan të shfaqin sot.

Ndaj, të nderuar kolegë, ju ftoj të votoni t'i dyja projektligjet dhe të vazhdojmë në rrugëtimin tonë: në rrugëtimin e përsheptimit të integritetit europian.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Fjalën e ka ministri Shalsi.

Eduard Shalsi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Momentet që po kalojmë natyrisht që nuk janë të lehta dhe imazhet që po përcjellin televizionet pasqyrojnë një copëz Shqipëri. Në

fakt, në këtë moment lind pyetja pse po ndodhin, cila është arsyeja që ndodhin këto dhe a ka një bazë kjo që po bën një pjesë e krerëve të opozitës? E kthejmë kokën pas, në vitin 2013, kur Shqipëria ishte në prag të humnerës, ishte në krizë financiare, krizë fiskale, krizë energjetike dhe krizë bankare, ndërkohë që vendi kishte nevojë ulëritëse për reformë.

Në vitin 2013 filluam të reformonim Shqipërinë, iniciuam një numër të konsiderueshëm reformash: reformën në arsim, reformën territoriale, reformën e jashtëzakonshme në energji, reformën e pensioneve dhe filluam të modernizonim vendin gradualisht, duke u kthyer dinjitetin disa institucioneve dhe sporteve, të cilat deri atëherë ishin paçavure.

Më kujtohet se në vitin 2008-2009 Partia Socialiste, ndonëse në opozitë, kërkoi të iniciohej një reformë, duke i shtrirë dorën Partisë Demokratike pikërisht për reformën në drejtësi. Pse e bëmë këtë?! Sepse të gjitha këto reforma nuk do të ishin të plota, nuk do të ishin efikase dhe nuk do të ishin eficiente pa kryer reformën më të rëndësishme, atë të drejtësisë. Shqiptarët kishin vite që lëngonin në një sistem drejtësie të kalbur, të degraduar dhe të korruptuar dhe pikërisht kësaj nevojë ulëritëse të shqiptarëve për drejtësi ne iu përgjigjëm duke iniciuar reformën në drejtësi. Ne e dinim që rruga nuk do të ishte e lehtë, që do të kalonim një rrugë shumë të vështirë, me pengesa të shumta dhe me shkopinj nën rrota. Pse? Sepse një pjesë e klasës politike nuk e donte reformën në drejtësi, mendonte dhe mendon ende se do të bjerë në rrjetën e sistemit të drejtësisë. Krerët e opozitës sot nuk kanë bërë thjesht gabime në të kaluarën, sepse gabimet në qeverisje falen dhe populli i ndëshkon me votë, sikundër ka bërë tri herë në mënyrë të njëpasnjëshme, por ata janë fajtorë. Ndaj Shqipëria dhe shqiptarët mezi presin që reforma në drejtësi të japë frytet e para.

Sot është një moment tjetër shumë i rëndësishëm, sepse po konstituohen dy organe shumë të rëndësishme, të cilat i hapin rrugën dhe çojnë më tej reformën në drejtësi. Tashmë jemi në finalen e konsolidimit të sistemit të drejtësisë, nga i cili shpresojmë dhe besojmë se askush që ka bërë faje të rënda në këtë vend të mos i shpëtojë dhe pikërisht në këtë moment delikat opozita vendos të largohet nga parlamenti.

Para disa ditësh një demokrat, i cili e konsideronte tradhti të largohej nga Partia Demokratike, më tha se sot i konsideron ata, të cilët i mbështeste, dezertorë, sepse janë larguar nga fronti i betejës. Të gjithë e dimë pse janë larguar. Ata nuk kanë se çfarë thonë dhe nuk dinë si të dalin nga kjo situatë, prandaj kanë zgjedhur këtë rrugë qorre dhe pa krye, që shumë shpejt, ne jemi të bindur dhe shqiptarët e dinë mirë, do t'i çojë drejt humnerës.

Sot kemi një betejë tjetër të madhe midis të djeshmes dhe të ardhmes, midis progresit dhe regresit, midis rrënimit dhe prosperitetit. Shqiptarët gjatë gjithë këtyre kohërave kanë ditur mirë të zgjedhin. Ne e dimë fare mirë se krerët e opozitës do të vazhdojnë me mjete të dhunshme, por nuk do të mund të ndalin dhe të pengojnë vullnetin tonë për ta bërë Shqipërinë më të mirë, më të drejtë, më dinjitoze dhe më të begatë.

Sot është momenti për të celebruar, pikërisht me vendimet që do të marrim, dy organet e reja, të cilat do të fillojnë të funksionojnë. Gradualisht, shumë shpejt edhe organet e tjera do të fillojnë të funksionojnë, laku po ngushtohet dhe kjo është arsyeja pse krerët e opozitës po përpeliten dhe janë të pashpresë. Ne e dimë fare mirë se njerëzit e dëshpëruar marrin vendime të dëshpëruara. Kushdo që pyet se çfarë është ky vendim, në fakt, duhet të kuptojë që është një vendim i logjikshëm për ata që i tremben drejtësisë, për ata që u tremben garave elektorale dhe kanë dalë përpara shqiptarëve me fytyrën e tyre të vërtetë.

Unë jam i bindur se edhe populli opozitar nuk përfaqësohet më nga ata krerë që kanë uzurpuar Partinë Demokratike. Nuk e di se sa do të jetë në gjendje Partia Demokratike të përtërijë vetveten, por a ka turp më të madh për një forcë politike, që ka ende kryetar të saj një personazh, i cili ka marrë peng historinë e Partisë Demokratike dhe është provuar dy herë nga shqiptarët?!

Natyrisht, ne vazhdojmë të jemi të vendosur, akoma edhe më shumë të motivuar, sepse është populli që ka nevojë për drejtësi dhe ne, si përfaqësues të tij, nuk mund të bëjmë gjë tjetër, vetëm të sigurojmë dhe të garantojmë shqiptarët që vullneti i tyre do të vendosë. Është vullneti i shqiptarëve që na jep forcë dhe fuqi. Shëmtia e opozitës së sotme është motivimi më i

fortë dhe më i madh për ne për të vazhduar të vendosur të reformojmë Shqipërinë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Shalsi!

Fjalën e ka deputetja Vasilika Hysi.

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë dhe kolege,

Të nderuar qytetarë, edhe ju qytetarë që po protestoni para sallës së Kuvendit të Shqipërisë,

Dëgjojmë thirrjet “E duam Shqipërinë si gjithë Europa”. Po, të gjithë e duam Shqipërinë si gjithë Europa, por Europa kërkon një drejtësi të pavarur, larg politikës, t’i themi “jo” pandëshkueshmërisë dhe barazi të qytetarëve para ligjit.

Sot në këtë seancë plenare ne po votojmë personelin dhe buxhetin e dy organeve të sistemit të drejtësisë: Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët kanë hedhur disa hapa shumë të rëndësishëm, edhe pse kanë hasur pengesa të mëdha në ngritjen e tyre.

Të nderuar qytetarë shqiptarë dhe ju ish-kolegë deputetë, që sot jeni në krye të protestës së dhunshme jashtë deryve të parlamentit, më lejoni t’ju them se në vitin 2016 votuam bashkë, maxhorancë dhe opozitë, ndryshimet kushtetuese dhe që nga viti 2016 deri në qershor të vitit 2017 nuk mundëm të ngrinim dot organet e vetingut. Pse? Sepse ish-kolegët e opozitës, sot në rrugë, penguan këtë proces duke e çuar çështjen në Gjykatë Kushtetuese, duke ngritur çadrën dhe duke mos ardhur në komisionet për zgjedhjen e anëtarëve të organeve të vetingut. Megjithatë, ne mundëm t’ia dalim dhe në fund i ngritëm këto organe. Po kështu, edhe për organet e sistemit të drejtësisë, për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, përsëri kolegët e opozitës nuk erdhën në parlament, u desh të shtyhej ky proces dhe më në fund arritëm të zgjedhim anëtarët jogjyqtarë dhe anëtarët joprokurorë.

Dua të theksoj arsyen pse seanca e sotme ka një rëndësi të jashtëzakonshme dhe nuk mund të shtyhej më. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë filluar punë shumë javë më parë, por po punojnë me një kapacitet të limituar njerëzish dhe pa buxhet. Ndërkohë, çfarë përfaqëson Këshilli i Lartë Gjyqësor për qytetarët, për ata që protestojnë dhe për ata që nuk protestojnë, për qytetarët që

mbështesin maxhorancën dhe për ata që mbështesin opozitën, por, mbi të gjitha, për të gjithë qytetarët shqiptarë që duan drejtësi dhe e duan Shqipërinë si gjithë Europa?! Këshilli i Lartë Gjyqësor u jep fund një herë e përgjithmonë emërimeve politike të gjyqtarëve. Besoj se edhe protestuesit jashtë kërkojnë gjyqtarë pa lidhje me politikën. Këshilli i Lartë Gjyqësor promovon gjyqtarë dhe prokurorë në bazë të karrierës së tyre, të vlerave të tyre dhe jo lidhjeve partiake e rryshfetit. Besoj se të gjithë qytetarët, pavarësisht bindjeve politike, e kërkojnë këtë. Këshilli i Lartë Gjyqësor bën vlerësimin e gjyqtarëve dhe i ndëshkon ata me masa disiplinore për shkeljen e etikës. Besoj se të gjithë shqiptarët, të majtë apo të djathtë qofshi ata, apo pa parti, kërkojnë pikërisht këtë. Këshilli i Lartë Gjyqësor mundëson standarde në gjykimin e çështjeve. Kush është ai qytetar i thjeshtë, i cili ka të drejtë të protestojë, por që nuk do një sistem gjyqësor dhe një drejtësi që ofrohet me gjyqtarë me integritet, të caktuar jo nga politika, por në bazë të meritës dhe që ndëshkojnë në mënyrë të barabartë si të varfrin edhe të pasurin, si atë qytetarin që nuk ka asnjë funksion publik, edhe atë që ka një funksion publik?

Këshilli i Lartë Gjyqësor zgjedh Gjykatën e Posaçme, zgjedh organin më të rëndësishëm, i cili do të hetojë ish-funksionarë dhe funksionarë.

Sot ish-kolegët e opozitës harrojnë se veprimet e dhunshme dhe të gjitha ato çfarë po bëjnë jashtë janë vepra penale, që do të hetohen dhe do të gjykohen nga SPAK-u (nuk ka rëndësi nëse ke mandat apo nuk ke mandat, mjafton të kesh qenë ish-funksionar i lartë), vepra të cilat shumë shpejt do t’i kalojnë Gjykatës së Posaçme.

Të nderuar kolegë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të cilin ne sot do t’i japim personelin dhe buxhetin, ka filluar punën. Këtu në këtë sallë kolegët e opozitës kërkonin Prokurorin e Përgjithshëm. A e dini, të nderuar qytetarë shqiptarë, ju që protestoni sot dhe ju që nuk protestoni, se propozimin për Prokurorin e Përgjithshëm e bën Këshilli i Lartë i Prokurorisë? A e dini, të nderuar qytetarë, sepse kolegët dhe ish-kolegët e opozitës nuk e dinë dhe nuk kanë për ta mësuar kurrë, që SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimit e zgjedh Këshilli i Lartë i Prokurorisë? A e dini, të nderuar qytetarë, se parimi i ndëshkueshmërisë, që ende nuk

ekziston, sot mundësohet falë krijimit të strukturave të posaçme, që do të hetojnë dhe do të gjykojnë funksionarë dhe ish-funksionarë, me mandate dhe pa mandate? A e dini, të nderuar qytetarë, se barazia para ligjit ka nevojë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për Këshillin e Lartë Gjyqësor që të funksionojë me kapacitete të plota, me buxhete të nevojshme dhe me burime njerëzore? Çfarë po bëjmë ne sot?! Po miratojmë personelin, atë personel që ka munguar në këtë periudhë që po funksionojnë, si dhe buxhetin e tyre.

Shpesh në studio janë pyetur të gjithë kolegët, madje edhe unë, pse mendojmë që opozita nuk e do reformën në drejtësi dhe maxhoranca e do?! E theksoj edhe një herë, të nderuar kolegë, maxhoranca ka një dallim nga kjo opozitë, është e përgjegjshme dhe e kupton se nuk mund të luhet me fatin e shqiptarëve, me fatin e Shqipërisë dhe me integritimin europian, me çështje kaq delikate, që dalin përtej interesave të majta apo të djathta, është në interesin e publikut.

Të nderuar kolegë, sot ne do të votojmë personelin dhe buxhetin e dy institucioneve shumë të rëndësishme, por ndërkohë na presin disa sfida të tjera. Ne kemi në proces dhe duhet të punojmë së bashku për të zgjedhur tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, për të cilën opozita bërtet fort se nuk kemi Gjykatë Kushtetuese. Po, nuk kemi. Ku është opozita sot, që Kuvendi të zgjedhë tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, sepse tre anëtarët e tjerë i ka Presidenti i Republikës dhe tre të tjerë i ka Gjykata e Lartë? “Nuk kemi Gjykatë të Lartë”, thotë opozita. Po, nuk kemi Gjykatë të Lartë, kanë ngelur pak gjyqtarë. A e dini ju që Gjykata e Lartë zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor? Pra, anëtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët do të zgjedhin edhe tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, zgjidhen nga ky Këshill, i cili sot ka nevojë për votat e maxhorancës dhe votat e opozitës.

Sot thirrja “E duam Shqipërinë si gjithë Europa” ka mbetur thjesht një slogan në gojën e opozitës, sepse detyrimet dhe përgjegjësitë që ne, si të zgjedhur të partive të ndryshme politike, kemi ndaj shqiptarëve, për fatin tonë të keq, kjo opozitë nuk i ushtron. Ndaj, mirë që e dëmtuan dhe e penguan këtë proces të reformës në drejtësi, por të paktën ta mësojnë kolegët e nderuar të opozitës se kjo reformë e ka marrë

rrugën e saj; nuk ka më kthim pas. Çdo veprim është në dëm të interesit të shqiptarëve, është në dëm të interesit të Shqipërisë dhe cenon rëndë integritimin europian.

Faleminderit, të nderuar kolegë!

Këtu mbyllet diskutimet e listës së diskutantëve.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste fjalën e ka deputeti Ulsi Manja.

Ulsi Manja - Të nderuar kolegë deputetë, Të dashur qytetarë shqiptarë,

Dikush nga jashtë po më shkruan se Lulzim Basha po këndon, siç di ai të këndojë: “Eja mblidhuni këtu-këtu”. Kjo është kënga më dëshpëruese e tij dhe e fundit, sepse reformën në drejtësi, SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimit nuk e pengon dot as sot dhe as mot. Ndërsa një ish-kolege e LSI-së qenka shkrehur në lot aty jashtë rreth një gome makine të ndezur dhe e dashka Shqipërinë pa Edi Ramën.

E nderuar zonjë dhe gjithë ju zonjat dhe zonjushat e LSI-së, por edhe të Partisë Demokratike, që po derdhni lot krokodili në errësirë, sepse tani nuk ju shikon më njeri se është natë: mos qani, ruani lotët, se Shqipëria nuk është as jona dhe aq më pak juaja, por e 99% të shqiptarëve të ndershëm dhe të zakonshëm të këtij vendi, që duan jetësimin e reformës në drejtësi, SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimit. Prandaj, ne, si shumicë, jemi sonte këtu dhe ju atje. Ju nuk do ta pengoni më as reformën në drejtësi dhe as rrugën europiane të Shqipërisë.

Të nderuar kolegë deputetë, çështja që po trajtojmë sot përbën një hap tjetër, shumë të rëndësishëm, drejt vënies në funksionim të organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Në këtë rrugëtim drejt përmbylljes së procesit, që i dhamë udhë në vitin 2016, me miratimin e paketës së ligjeve të drejtësisë, asgjë nuk ka qenë e lehtë, madje në fillim gjithçka dukej e pamundur. Në këtë rrugëtim tonin shumëkush ka kërkuar defektin për të justifikuar bllokimin, por ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe votimi i numrit të punonjësve, i buxhetit, që do të bëjmë ne sonte, tregojnë se është jo vetëm një proces pa kthim, por një realitet i ri, që i ka dhënë frymëmarrjen e duhur sistemit, në kaq pak kohë të funksionimit të tyre, edhe pse me kapacitete të pakta të burimeve njerëzore në dispozicion, që do të plotësohen sonte me votën tuaj, të nderuar

kolegë! Asnjë surprizë nuk ka dhe nuk do të ketë më me reformën në drejtësi. Ndaj, gjithçka po ndodh ishte e parashikuar prej nesh që në fillim, duket se jemi në rrugë të mbarë.

Sot po miratojmë numrin e punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe i hapim rrugë buxhetimit të këtyre institucioneve. Ndaj zhurma e protestës së të arratisurve nga parlamenti, që kanë humbur rrugën me mungesën e votës për këto dy organe të qenësishme të reformës në drejtësi, është shpjegimi më domethënës, pse ata janë aty përjashta.

Të nderuar kolegë deputetë, Komisioni i Ligjeve përpara se të përcillte draftet e akteve për miratim të ju, zhvilloi konsulta pune dhe takime sqaruese me përfaqësuesit e të dyja organeve dhe në mbledhjen e datës 19 shkurt 2019 miratoi dhe propozon për Këshillin e Lartë të Gjyqësor një numër prej 125 punonjësish dhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë një numër prej 65 punonjësish. Nuk qe e lehtë të arrinim në konkluzionin që ju kemi përcjellë, sepse duhet të mbanim mirë në balancë nevojat me mundësitë, dëshirën për të bërë sa më shumë, me nevojën për ta bërë sa më mirë.

Besojmë se propozimi i plotëson nevojat e sotme të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe u mundëson atyre fillimin e operimit me ato që u detyron ligji.

Komisioni gjykoi se numri prej 125 punonjësish për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe 65 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë u përshtatet nevojave për fillimin e punës dhe gjatë vitit, në varësi të kërkesave të reja të këtyre dy këshillave për plotësime në numër punonjësish, Kuvendi mund ta rivlerësojë këtë çështje. Kjo për faktin se po Kuvendi është përgjegjës për përcaktimin e numrit të punonjësve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Gjykatës së Posaçme Antikorrupsion. Pas akomodimit të nevojave të të gjitha institucioneve, numri i punonjësve tek të dy këshillat mund edhe të rishikohet në raport me nevojat që do të hasen gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre.

Sa më sipër, ju ftoj të votoni projektvendimin dhe ta regjistrujmë si të kryer edhe një detyrë tjetër që na kanë dhënë

shqiptarët, sepse, si shumicë qeverisëse, e dimë dhe e kemi të qartë se mandati ynë është mandati i jetësimi të plotë të reformës në drejtësi, kundrejt atyre që i dogjën mandatet, si përpjekjen e fundit për të penguar drejtësinë e re që po lind, por edhe kësaj here do të dështojnë me sukses.

Të nderuar kolegë, vota jonë sot është përgjegjësi, sepse përfaqëson ata qytetarë të djathtë dhe të ndershëm, që e duan të kryer reformën në drejtësi, por vota jonë është historike, sepse buxheti i këtyre dy institucioneve miratohet pa votën e Saliut, të Lulit dhe të Monikës.

Ju ftoj ta voni.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zoti Gramoz Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Manja!

Këtu përfundojnë edhe diskutimet për projektvendimet “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Kalojmë te projektvendimi “Për zgjedhjen e një anëtarit të Bordit të ERE”.

A do të shprehet komisioni ose relatori? Nuk do të shprehen.

Kalon për votim.

Kalojmë te projektvendimi “Për zgjedhjen e kryetarit të Bordit të ERE”.

A do të shprehet komisioni ose relatori? Nuk do të shprehen.

Kalojmë te projektvendimi “Për miratimin e kandidatave për pozicionet e komisionerëve pranë Avokatit të Popullit”.

A do të shprehet komisioni ose relatori? Nuk do të shprehen.

Projektvendim “Për zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar”.

Urdhëroni, zonja Ekonomi!

Milva Ekonomi – Kërkojmë që votimi për zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar të shtyhet për seancën tjetër.

Gramoz Ruçi – Këtu përfundon shqyrtimi i çështjeve që kishim sot në rendin e ditës dhe bëhemi gati për votimin

Fillojmë procesin e votimit.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 26 SHKURT 2019

Para se të kalojmë te projektligjet e parashikuara për votim, hapim votimin për prezencën.

Të hiqen kartat e deputetëve: Pendavinji, Lala, Koka, Noka, Hajdari, Murrizi, Rama.

Mbyllet votimi për prezencën.

Janë 72 deputetë prezentë.

Fillojmë me projektligjin “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, projektligji kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Me 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen, me kartonë, sipas propozimeve të komisioneve që kanë shqyrtuar projektligjin.

Para se të fillojmë me nenin 1, votojmë shënimin në fund të faqes, që lidhet me titullin e projektligjit, që tregon përputhshmërinë me legjislacionin e Bashkimit Europian. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Fillojmë me nenet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18, me vërejtjet e të dyja komisioneve për pikën 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23, me vërejtjet e të dyja komisioneve për pikën 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 24. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 26 SHKURT 2019

Neni 26. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 27. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 28. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 29. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 30. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 31. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 32. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 33. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 34. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 35. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 36. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 37. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 38. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, miratohet edhe në tërësi projektligji.

Vazhdojmë me projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar"". Edhe ky

projektligj, sipas Kushtetutës dhe Rregullores, kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Me 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, miratohet.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen, me kartonë, sipas variantit integral të paraqitur nga Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, i cili reflekton edhe vërejtjet e komisionit për dhënie mendimi, që është Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Neni 1. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, miratohet edhe në tërësi projektligji.

Vazhdojmë me projektligjin "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë për tokën bujqësore", të ndryshuar"". Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, edhe ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Me 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, miratohet në parim.

Vazhdojmë shqyrtimin nen për nen, me kartonë, sipas variantit integral të paraqitur nga Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, së bashku me vërejtjet e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Neni 1. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 26 SHKURT 2019

Miratohet.
Neni 2. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.
Neni 3. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.
Neni 4. Kush është pro? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.
Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, miratohet edhe ky projektligj.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për miratimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, projektvendimi kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Ju rikujtoj se komisioni përgjegjës ka paraqitur vendimin përkatës. Pra do të votohet varianti i komisionit përgjegjës, që në rastin konkret është Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Është vetëm një votim i hapur me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, miratohet.

(Duartrokitje në sallë)

Vazhdojmë me projektvendimin “Për miratimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Edhe ky projektvendim, në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Edhe për këtë projektvendim ju rikujtoj se komisioni përgjegjës ka paraqitur projektvendimin përkatës, pra do të votohet varianti i komisionit përgjegjës. Është vetëm një votim i hapur me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, miratohet.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për emërimin e një anëtar i të Bordit të

komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë”. Edhe ky projektvendim, në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Në mbështetje të nenit 11 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, anëtar i Bordit propozohet nga ekipi përzgjedhës, i përbërë nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, kryetari i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Ekipi përzgjedhës ka propozuar kandidaturat e mëposhtme: Maksim Shuli dhe Mynyr Sinanaj.

Procedura e votimit është: dy votime, ku çdo votim është më vete, i fshehtë dhe me elektronikë.

Hapet votimi i fshehtë me elektronikë...

Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hapet votimi i fshehtë, me elektronikë, për zotin Maksim Shuli.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim për zotin Shuli.

Hapet votimi i fshehtë, me elektronikë, për zotin Mynyr Sinanaj.

Mbyllet votimi.

Asnjë votë pro, 10 vota kundër, 62 vota abstenim.

Pra, miratohet kandidatura e zotit Maksim Shuli, si anëtar i Bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për emërimin e kryetarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë”. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, kandidaturat kërkojnë shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Në mbështetje të nenit 11 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, edhe kryetari i Bordit propozohet nga ekipi përzgjedhës, i përbërë nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, kryetari i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, dhe kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Ekipi përzgjedhës ka propozuar kandidaturat e mëposhtme: Petrit Ahmeti dhe Agim Nashi.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 26 SHKURT 2019

Procedura e votimit: dy votime, ku çdo votim është më vete, i fshehtë dhe me elektronikë.

Hapet votimi i fshehtë, me elektronikë, për zotin Petrit Ahmeti.

Mbyllet votimi.

70 vota pro, një votë kundër dhe një votë abstenim.

Hapet votimi i fshehtë, me elektronikë, për zotin Agim Nashi.

Mbyllet votimi.

3 vota pro, 8 vota kundër dhe 61 vota abstenim.

Pra, miratohet kandidatura e zotit Petrit Ahmeti, si kryetar i Bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për miratimin e kandidaturave për pozicionet e komisionerëve pranë Avokatit të Popullit”.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, kandidaturat kërkojnë shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Në mbështetje të ligjit nr. 8454 “Për Avokatin e Popullit”, kandidaturat për komisionerë propozohen nga Avokati i Popullit. Për çdo vend vakant Avokati i Popullit dërgon në Kuvend katër kandidatura.

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 33 të ligjit të mësipërm, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pas zhvillimit të seancave dëgjimore dhe përzgjedhjes, i propozon seancës plenare dy kandidatura për çdo vend vakant. Kështu, komisioni propozon për vendin vakant për komisioner në Seksionin e Përgjithshëm kandidaturat: Vilma Shurdha dhe Andi Nano.

Për vendin vakant për komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor komisioni propozon kandidaturat: Ermonela Ruspi dhe Ilir Kadiu.

Për vendin vakant për komisioner në Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të tretëve për llogari të tyre komisioni propozon kandidaturat: Edlira Cimbë dhe Eriona Canaj.

Procedura e votimit: janë gjashtë votime, ku çdo votim është më vete, i fshehtë dhe me elektronikë.

Hapet votimi i fshehtë, me elektronikë, për zonjën Vilma Shurdha.

Mbyllet votimi.

70 vota pro, një votë kundër, një votë abstenim.

Hapet votimi i fshehtë, me elektronikë, për zotin Andi Nano.

Mbyllet votimi.

64 abstenime, 4 kundër, 4 pro.

Pra, vendin vakant për komisioner për Seksionin e Përgjithshëm e fiton zonja Vilma Shurdha.

Hapet votimi i fshehtë me elektronikë për zonjën Ermonela Ruspi.

Mbyllet votimi.

71 pro, 1 abstenim.

Hapet votimi i fshehtë me elektronikë për zotin Ilir Kadiu.

Mbyllet votimi.

7 pro, 10 kundër, 55 abstenime.

Atëherë, fiton zonja Ruspi.

Hapet votimi i fshehtë me elektronikë për zonjën Edlira Cimbë.

Mbyllet votimi.

8 pro, 7 kundër, 57 abstenime.

Hapet votimi i fshehtë me elektronikë për zonjën Eriona Canaj.

Mbyllet votimi.

69 pro, 1 kundër, 2 abstenime.

Fiton zonja Eriona Canaj.

Këtu mbyllet edhe votimi për kandidaturat për pozicionet e komisionerëve pranë Avokatit të Popullit.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PS-së, kjo çështje shtyhet për seancën e ardhshme.

Vazhdojmë me projektvendimin për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”. Ky projektvendim, sipas nenit 78 të Kushtetutës

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË MARTË, 26 SHKURT 2019

dhe nenit 55 të Rregullores, kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 28 të Rregullores, a ka dëshirë të shprehet njeri pro apo kundër projektvendimit? Nuk ka.

Ky projektvendim u është shpërndarë deputetëve. Komisioni përgjegjës është Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Komisione për dhënie mendimi janë: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Politikën e Jashtme.

Kemi një votim të hapur me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Atëherë, ju njoftoj për draftprogramin e punës së Kuvendit për periudhën 4 mars -12 prill 2019 dhe draftkalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 4-22 mars 2019.

Sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila diskutoi draftprogramin e punës së Kuvendit dhe draftkalendarin 3-javor për periudhën në vijim. Në Konferencë pati konsensus. Për pasojë, në mbështetje të nenit 26, pika 5, dhe nenit 27, pika 3, të Rregullores, programi i punës dhe kalendarin e punimeve i njoftohen Kuvendit. Këto do t'i gjeni të publikuara edhe në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Këtu mbarojnë të gjitha çështjet që kishim në rendin e ditës së sotme.

Ju falënderoj për kontributin!

Natën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 20:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

Drejtori i Shërbimit të Botimeve

Parlamentare

Krenar Hajdëri